



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2018 – Numri: 134

**Tiranë – E martë, 18 shtator 2018**

## PËRMBAJTJA

|                                                             |                                                                                                                                                                                                                                           | Faqe |
|-------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|
| Ligj nr. 39/2018, datë 9.7.2018                             | Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.....                                                                                                                       | 9177 |
| Vendim i Kuvendit<br>nr. 94/2018, datë 13.9.2018            | Për rrëzimin e dekretit nr. 10850, datë 30.7.2018, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin e ligjit nr. 39/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat””, të ndryshuar”..... | 9178 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 524, datë 11.9.2018 | Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, “Mbi gruan, paqen dhe sigurinë”, 2018–2020.....                                                                       | 9178 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 525, datë 11.9.2018 | Për disa ndryshime në vendimin nr. 313, datë 1.7.2002, të Këshillit të Ministrave, “Për caktimin e strukturës, të numrit të punonjësve dhe shpenzimeve buxhetore të Policisë së Bashkisë dhe Komunës”, të ndryshuar.....                  | 9198 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 527, datë 11.9.2018 | Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2018, ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për financimin e studim-projektimit për ndërtimin e korpusit të Policisë së Shtetit.....              | 9198 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 528, datë 11.9.2018 | Për një ndryshim në vendimin nr. 34, datë 20.1.2001, të Këshillit të Ministrave, “Për sistemimin në apartamente banimi të familjeve që banojnë në territorin e Portit të Durrësit”, të ndryshuar.....                                     | 9199 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 532, datë 11.9.2018 | Për miratimin e rregullave për tregtimin, transportin, ruajtjen dhe magazinimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve.....                                                                                                                  | 9199 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 533, datë 11.9.2018 | Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Spiro Dede.....                                                                                                                                                                              | 9208 |



**LIGJ**  
**Nr. 39/2018**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA**  
**NË LIGJIN NR. 8438, DATË 28.12.1998,**  
**“PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”,**  
**TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

**Neni 1**

Në nenin 8/1, pika 11, paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“11. Të ardhurat e realizuara nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi tokën bujqësore nga një fermer i regjistruar te një fermer tjetër apo një person fizik a juridik që kryen aktivitet bujqësor. Përfshihen, gjithashtu, rastet e kalimit të së drejtës së pronësisë brenda lidhjes gjinore burrë, grua, fëmijë, nëpërmjet dhurimit dhe/ose heqjes dorë nga pasuria, kur pasuria rrjedh nga bashkëpronësia e detyrueshme e fituar në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, të ndryshuar.”.

**Neni 2**

Në nenin 11, pika 1, ndryshohet si më poshtë:

“1. Fitimi kapital i realizuar si rezultat i kalimit të së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, ndërtesë, truall dhe tokë bujqësore, tatohet me normën 15 për qind.

Shkëmbimi i truallit me sipërfaqe ndërtimi, në bazë të një kontrate shkëmbimi, nuk përbën moment për llogaritje të ndonjë fitimi kapital nga transferimi i pasurisë së paluajtshme.”.

**Neni 3**

Në nenin 20, paragrafët e tretë dhe të katërt shfuqizohen.

**Neni 4**

Në nenin 28 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Shkalla e tatimit mbi fitimin është:

- 5 % për tatimpaguesit me të ardhura deri në 14 000 000 lekë në vit.

- 15 % për tatimpaguesit me të ardhura mbi 14 000 000 lekë në vit.”.

2. Pas pikës 2 shtohen pikat 3 dhe 4 me këtë përmbajtje:

“3. Për personat juridikë, të cilët zhvillojnë veprimtari ekonomike sipas ligjit nr. 38/2012, “Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor”, shkalla e tatimit mbi fitimin është 5 %.

4. Për subjektet, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si “agroturizëm”, sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit, shkalla e tatimit mbi fitimin është 5 %. Kjo shkallë aplikohet për një periudhë 10-vjeçare për personat juridikë që përfitojnë statusin “subjekt i certifikuar agroturizmi”, deri më 31 dhjetor 2021. Aplikimi i shkallës së reduktuar fillon në vitin tatimor pasardhës, pas përfitimit të statusit “subjekt i certifikuar agroturizmi.”.

**Neni 5**

Në nenin 33/1 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 2 hiqen fjalët “dhe personat fizikë”, “/vendimin e personit fizik”, si dhe “për çdo muaj vonesë”.

2. Në pikën 4 hiqen fjalët “/vendimi i personit fizik”.

**Neni 6**

Në nenin 38, pika 7, paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

“Tatimi mbi lojërat e fatit, sipas nenit 52/2, të ligjit nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, aplikohet me shkallën 15 % mbi të ardhurat bruto nga loja për të gjitha kategoritë e lojërave të fatit, përfshirë Lotarinë Kombëtare të licencuar sipas ligjit nr. 95/2013. E ardhura bruto nga loja është shuma e mbetur organizatorit nga diferenca midis shumës totale të luajtur nga lojtarët në lojërat e fatit dhe shumës së fituar prej tyre.

Tatimi mbi fitimin llogaritet në përputhje me dispozitat e këtij ligji.”.



Neni 7

**Dispozitë kalimtare**

Neni 2, që ndryshon nenin 20, “Shpenzime të njohura”, të ligjit, nuk do të zbatohet për kontratat e shkëmbimit që janë regjistruar në ZRPP para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, me përjashtim të nenit 3, i cili hyn në fuqi më 1 janar 2019.

**KRYETARI  
Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 9.7.2018

**VENDIM  
Nr. 94/2018**

**PËR RRËZIMIN E DEKRETIT NR. 10850,  
DATË 30.7.2018, TË PRESIDENTIT  
TË REPUBLIKËS, “PËR KTHIMIN E  
LIGJIT NR. 39/2018 “PËR DISA  
NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN  
NR. 8438, DATË 28.12.1998, “PËR  
TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË  
NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 85, pika 2, të Kushtetutës dhe të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Rrëzimin e dekretit nr. 10850, datë 30.7.2018, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin e ligjit nr. 39/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI  
Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 13.9.2018

**VENDIM**

Nr. 524, datë 11.9.2018

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË  
VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E  
REZOLUTËS 1325 TË KËSHILLIT TË  
SIGURIMIT TË KOMBEVE TË  
BASHKUARA, “MBI GRUAN, PAQEN  
DHE SIGURINË”, 2018–2020**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, “Mbi gruan, paqen dhe sigurinë”, 2018–2020, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen të gjitha ministritë dhe institucionet qendrore, të përmendura në planin e veprimit, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
Senida Mesi**

**PLAN NDËRINSTITUCIONAL  
VEPRIMI**

**PËR ZBATIMIN E REZOLUTËS 1325 TË  
KSOKB-së “MBI GRUAN, PAQEN DHE  
SIGURINË”, 2018–2020  
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË  
Gusht 2018**

Ky dokument është përgatitur në emër të qeverisë së Shqipërisë, nga Ministria e Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në konsultim të ngushtë me përfaqësues të autoriteteve vendore, organizatave ndërkombëtare dhe me kontributin e përfaqësuesve të shoqërisë civile përfshirë edhe ekspertë të fushës.

Shtypa, ekspertizë dhe asistencë teknike për përgatitjen e dokumentit janë dhënë nga vende me angazhim të rëndësishëm në zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së



Kombeve të Bashkuara “Për gruan, Paqen dhe Sigurinë” (Rezoluta 1325), si Vendet e Ulëta dhe Suedia, përmes zyrave të përfaqësisë së tyre diplomatike në Shqipëri, si dhe organizatat ndërkombëtare si Organizata e Kombeve të Bashkuara përmes “Fondi për Barazinë Gjinore, UN Women” (UNWOMEN) në Tiranë, Prezenca e Organizatës për Siguri e Bashkëpunim në Evropë në Shqipëri (OSBE) dhe Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri, me synimin e reflektimit të universalitetit të Rezolutës 1325. Mbështetja më thelbësore është dhënë përmes projektit “Rezoluta 1325” financuar nga Ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta dhe “Fondi për Barazinë Gjinore, UN Women” dhe zbatuar nga Shoqata e Grave me Probleme Sociale”, dhe “Rrjeti për Fuqizimin e Gruas Shqiptare, AËEN”. “Koalicioni për Rezolutën 1325” krijuar nga organizata të shoqërisë civile (OSHC) ka qenë kontribues në procesin e hartimit të këtij Plani Veprimi.

#### I. HYRJE

Shqipëria ka realizuar një progres të konsiderueshëm në përshtatjen e politikave të vlefshme për fuqizimin e grave dhe arritjen e barazisë gjinore në vend, duke qenë në përputhje me detyrimet që rrjedhin edhe nga aktet rajonale dhe ndërkombëtare për këtë çështje. Po aq, Shqipëria është e angazhuar për arritjen e paqes dhe të stabilitetit në botë dhe zbatimin e detyrimeve të Kombeve të Bashkuara apo organizmave të tjerë rajonalë lidhur me paqen dhe stabilitetin, sa me pjesëmarrjen aktive në të tilla angazhime ndërkombëtare apo rajonale, si dhe përfshirjen e këtyre angazhimeve në mënyrë të integruar në politikat e brendshme të vendit.

Duke njohur rëndësinë e rolit të grave në përfundimin e sigurisë dhe parandalimin e konflikteve, një ndër angazhimet ndërkombëtare që integron fuqizimin e grave në ruajtjen e paqes dhe sigurisë, është miratimi në vitin 2000 nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, posaçërisht Këshilli i Sigurimit, i Rezolutës 1325 “Për gratë, paqen dhe sigurinë” (Rezoluta 1325 e KSOKB-së), e cila vë në plan të parë një agjendë për gratë, paqen e sigurinë në botë (agjenda GPS).

Në kuadër të promovimit të qeverisjes së përgjegjshme gjinore dhe rritjes së pjesëmarrjes së grave në jetën politike dhe publike, si një kusht për zhvillimin e qëndrueshëm dhe qeverisjes së mirë, Shqipëria ka ndërmarrë hapa të shumtë në drejtim

të përfundimit të politikave për barazinë gjinore, me qëllim kontributin në shoqëri të vlerave konkrete të të gjithë anëtarëve të shoqërisë dhe krijimin në vend të një shoqërie që vlerëson barazinë gjinore si një parakusht për zhvillimin e qëndrueshëm dhe që synon drejt zero tolerancës kundër dhunës në baza gjinore dhe dhunës në familje<sup>1</sup>.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, dokumenti bazë që mbron liritë dhe të drejtat themelore, sanksionon parimin e barazisë si themelor dhe si kusht të domosdoshëm për mbarëvajtjen e të gjithë veprimtarisë në vend. Bazuar në të, një sërë ligjesh që adresojnë çështje me bazë gjinore janë miratuar në vijimësi, si ligji për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare në vitin 2006, ligji për barazinë gjinore në vitin 2008, ligji për mbrojtjen kundër diskriminimit në vitin 2010 etj. Ndër dokumentet politike që adresojnë dhe vendosin masa konkrete për çështjet gjinore, Republika e Shqipërisë miratoi strategjinë e 3-të Kombëtare “Për Barazinë Gjinore dhe të Planit të Veprimit 2016–2020” në vitin 2016, shtyllat kryesore të së cilës përfshijnë:

- Barazia gjinore, kusht për një shoqëri të drejtë, të qëndrueshme e socio-ekonomikisht të zhvilluar,
- Ndjeshmëri dhe trajtim i barabartë ndaj nevojave të veçanta të të dyja gjinive,
- Njohja, vlerësimi dhe respektimi i diversitetit,
- Tolerancë zero kundrejt dhunës ndaj grave e dhunës në familje,
- Koordinimi dhe bashkëpunimi ndër-institucional.

Pavarësisht këtyre shtyllave themelore, përfshirja gjinore dhe adresimi i çështjeve me bazë gjinore në fushën e sigurisë ende nevojitet të adresohet. Direktiva e ministrit të Mbrojtjes dhe udhëzimet e shefit të Shtabit të Përgjithshëm për veprimtarinë e FA-së për vitin 2017 adresojnë për herë të parë edhe çështjet e barazisë gjinore, duke parashtruar synimin që personeli ushtarak profesionist femër në Forcat e Armatosura të përbëjë deri 15% të numrit të përgjithshëm të tyre, si dhe për çdo strukturë veç e veç, në funksion të misionëve dhe detyrave sipas niveleve operacionale të kërkuara. Realiteti tregon për një ndërgjegjësim të pjesëmarrjes së grave në jetën politikëbërëse, por

<sup>1</sup> Vizioni i Strategjisë Kombëtare për barazinë gjinore dhe të planit të veprimit 2016–2020, miratuar në vitin 2016, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 733, datë 20.10.2016.



ende ka shumë për të arritur. Shqipëria, pas zgjedhjeve të përgjithshme të 2017-ës pati 27.86% të deputeteve femra në Kuvend, duke u renditur në vendin e 54 nga 193 vende në dhjetor 2017,<sup>2</sup> ndërsa, aktualisht, përqindja rezulton të jetë 29.3% me 41 deputete femra. Në vitin 2017 u rrit numri i ambasadoreve femra në 26% dhe konsulle të përgjithshme femra në 33%, duke arritur nivelin më të lartë që ka pasur shërbimi i jashtëm.<sup>3</sup> Kjo rritje duhet ruajtur e përforcuar më tej. Gratë ende janë pak pjesëmarrëse e kontribuese në fushën e sigurisë. Përqindja e grave në Policinë e Shtetit në janar 2018 rezulton të jetë 14.2%, nga të cilat 9.7% janë punonjëse policie, ndërsa në pozicione drejtuese: drejtues madhor 0%, drejtues i lartë 20%, drejtues i parë 0%, drejtues 8%.<sup>4</sup> Po ashtu, edhe pse numri femrave në Forcat e Armatosura u shtua me 14 gjatë vitit 2017 krahasuar me 2016, femrat personel ushtarak ende zënë gjithsej rreth 10% të Forcave të Armatosura. Gjatë vitit 2017 femrat në pozicione pune në përfaqësitë ushtarake jashtë vendit zënë 16% të totalit, me vetëm 1 femër oficerë nga 6 që shërbenin në këtë pozicion gjatë 2016. Në vitin 2017 kanë marrë pjesë në misione/operacione jashtë vendit vetëm 4.4% femra.<sup>5</sup>

Konsideruar sa më lart, pavarësisht masave konkrete dhe zbatimit të politikave konkrete me bazë gjinore, miratimi i një plani veprimi në kuadër të Rezolutës 1325 të KSOKB-së, bazuar në një fotografim të situatës aktuale në Shqipëri dhe identifikim të problematikave që has vendi ynë në zbatimin e plotë të rekomandimeve në kuadër të Rezolutës 1325, është i nevojshëm, duke synuar që ky plan të rishikohet në vijimësi. Qëllimi i këtij Planit është garantimi i politikave të zgjuara të përfshirjes së grave në fushën e sigurisë, të veprimtarisë së jetës që kanë të bëjnë me paqen dhe sigurinë dhe adresimit të çështjeve me të cilat

përballen ato në kësi situatash apo pas tyre. Po aq, ky Plan Veprimi synon të mundësojë një zbatimin edhe më të mirë të Rezolutës 1325 në përputhje me angazhimet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë.

Plani Ndërinstitucional i Veprimit (Plani i Veprimit) është një angazhim i institucioneve qendrore të larta politikëbërëse në vend që veprojnë në fushën e sigurisë dhe të ruajtjes së paqes, çështjeve gjinore, si dhe që adresojnë angazhimet ndërkombëtare të vendit. Ky Plan Veprimi është angazhim i Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Shëndetit dhe Çështjeve Sociale, si dhe i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme. Ky plan ka një kohështrirje dyvjeçare, 2018–2020. Plani i Veprimit reflekton situatën aktuale dhe masat në zbatim të saj, si dhe pasqyron nisjen e aktiviteteve të reja për nxitjen dhe fuqizimin e rolit të grave në sektorin e sigurisë në Shqipëri, por edhe angazhimin e vendit në këtë sektor ndërkombëtarisht.

Plani i Veprimit u mbështet në të gjitha fazat përgatitore deri në finalizimin e tij nga partnerët ndërkombëtarë, si dhe përfaqësues të shoqërisë civile në vend.

Ky Plan Veprimi synon të jetë një bazë kuptimplote për hartimin e një Planit Kombëtar Veprimi, në respektim të plotë të kërkesës sipas Rezolutës 1325 të KSOKB-së.

## II. REZOLUTA 1325 DHE REZOLUTAT MBËSHETËSE TË SAJ

Duke pranuar natyrën e ndryshueshme të konflikteve të përkohshme, të cilat prekin më shumë popullsinë civile se sa forcat ushtarake të përfshira në luftime, më 31 tetor 2000, Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara miratoi unanimisht Rezolutën 1325 “Për gratë, paqen dhe sigurinë”. Kjo Rezolutë shënoi një moment vendimtar në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të grave në përgjithësi, përfshirë rolin e grave dhe përgjegjësitë e tyre zyrtarisht në agjendën ndërkombëtare të sigurisë, si dhe ndryshoi konceptin e sigurisë në mbarë botën. Rezoluta 1325 thekson rëndësinë e pjesëmarrjes së barabartë dhe të plotë të grave si agjente aktive në parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve, negociatat e paqes, ndërtimin e paqes, paqeruajtjen, përgjigjen humanitare dhe në rindërtimin pas konfliktit.

<sup>2</sup> Klasifikimi botëror i “Gratë në parlamentet kombëtare” realizuar nga *Inter-Parliamentary Union*, një organizatë ndërkombëtare e përbërë nga parlamentet kombëtare, bazuar në informacionet e parlamenteve kombëtare në dhjetor 2017. Shih në: <http://archive.ipu.org/wmn-e/classif.htm>

<sup>3</sup> Informacion zyrtar i marrë nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, në janar 2018.

<sup>4</sup> Informacion zyrtar i marrë nga Ministria e Brendshme, në janar 2018.

<sup>5</sup> Informacion zyrtar i marrë nga Ministria e Mbrojtjes, në janar 2018



Rezoluta 1325 e KSOKB-së është dokumenti i parë zyrtar i miratuar nga KSOKB për t'u vënë në jetë nga të gjitha vendet anëtare. Ajo u bën thirrje shteteve anëtare të OKB-së dhe kërkon atyre të marrin masa, për:

- rritjen e përfaqësimit të grave në të gjitha nivelet vendimmarrëse në institucionet dhe mekanizmat kombëtarë, rajonalë dhe ndërkombëtarë për parandalimin, menaxhimin dhe zgjidhjen e konflikteve;

- nxitjen e zgjerimit të rolit dhe kontributit të grave në operacione paqeruajtëse;

- përfshirjen e perspektivës gjinore në politikat kombëtare për mbrojtjen dhe sigurinë;

- trajnimin e njësive kombëtare të sigurisë dhe të mbrojtjes për të drejtat dhe nevojat e veçanta të grave;

- të kuptuar rëndësinë e përfshirjes së grave në hartimin dhe zbatimin e të gjitha politikave të sigurisë dhe mbrojtjes, në të gjitha masat paqeruajtëse, si edhe përfshirjen e të gjitha këtyre çështjeve në programet kombëtare të trajnimit për personelin ushtarak dhe atë policor;

- marrjen e masave të posaçme për të mbrojtur gratë dhe vajzat nga dhuna me bazë gjinore, sidomos nga përdhunimi dhe nga format e tjera të shfrytëzimit seksual, duke rritur shkallën e ndëshkimit dhe duke ndjekur penalisht të gjithë ata që janë përgjegjës për krimet ndaj grave;

- mbajtjen në konsideratë të nevojave të posaçme të grave dhe vajzave, si edhe efektet e mundshme mbi popullatën civile, gjatë hartimit të politikave në fushën e paqes, sigurisë dhe mbrojtjes.

Me qëllim përshpejtimin e vënies në zbatim të Rezolutës 1325, gjatë 17 viteve të fundit, Këshilli i Sigurimit i OKB-së, ka miratuar një varg rezolutash simotra për gratë, paqen dhe sigurinë, përkatësisht:

1. Rezoluta 1820 (2008), “Dhuna seksuale në situata konflikti dhe postkonflikt” ku theksohet parandalimi dhe përgjigjja ndaj dhunës seksuale në situatat e konfliktit të armatosur dhe në fazën e paskonfliktit.

2. Rezoluta 1888 (2009), “Mbrojtja e grave dhe fëmijëve nga dhuna seksuale në konfliktet e armatosura”, e cila përforcon Rezolutën 1820, edhe duke caktuar një përfaqësues special të OKB-së dhe një grup ekspertësh për promovimin e ndalimit të përdhunimeve gjatë konflikteve të armatosura.

3. Rezoluta 1889 (2009), “Mbrojtja e grave dhe

vajzave nga dhuna seksuale në situata postkonflikt”, ku theksohet rëndësia e pasjes së një tërësie treguesish të matshëm, burimeve financiare, monitorimit dhe raportimit periodik lidhur me zbatimin e Rezolutës 1325.

4. Rezoluta 1960 (2010) e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në lidhje me gratë, paqen dhe sigurinë, siguron një sistem llogaridhënës për ndalimin e dhunës seksuale në konflikt, duke përcaktuar një sistem për mbledhjen strategjike, të koordinuar dhe në kohë të të dhënave për dhunën seksuale në situata konflikti, si dhe që shtetet anëtare të OKB-së të miratojnë angazhime konkrete për këtë.

5. Rezoluta 2106 (2013) e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për gratë, paqen dhe sigurinë (RKSKB 2106), konkretizon më tej kërkesat për angazhime ndaj të gjitha strukturave të Kombeve të Bashkuara dhe shteteve anëtare.

6. Rezoluta 2122 (2013) e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për gratë, paqen dhe sigurinë kërkon shprehimisht rritjen e kapaciteteve teknike të grave për misionet paqeruajtëse dhe ekipet e ndërmjetësimit, të informimit të tyre për situata të tilla, si dhe angazhime të shteteve për të përfshirë gratë drejtpërdrejt në bisedimet e paqes, si dhe adreson specifikisht çështjen e abuzimeve seksuale dhe shëndetit riprodhues.

7. Rezoluta 2242 (2015) e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për gratë, paqen dhe sigurinë (RKSKB 2242), adresoi çështje të sigurisë në një kontest edhe më të gjerë, përfshirë edhe problematikat e lidhura me mjedisin, pandemitë shëndetësore, zhvendosjet masive të njerëzve, ekstremizmin e dhunshëm, si dhe rivendosi në vëmendje nevojën e përfshirjes së grave në pozicione të larta drejtuese, bisedime paqe, forcimin e kapacitetit të tyre në lidhje me sigurinë, por edhe pamjaftueshmërinë e mbështetjes financiare të organizatave të grave.

8. Rezoluta 2331 (2016) e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për gratë, paqen dhe sigurinë (RKSKB 2331), duke risjellë në vëmendje angazhimet e mëparshme në kuadër të agjendës GPS, e vuri theksin te trafikimi i qenieve njerëzore dhe si ky trafikim ushqen pasigurinë.

OKB-ja, NATO-ja dhe OSBE-ja, si dhe BE-ja kanë njohur rolin e rëndësishëm që luajnë gratë në zgjidhjen e konflikteve. Vëmendje e veçantë në rezolutat e mësipërme i kushtohet përfshirjes së



perspektivës gjinore në të gjitha fazat e planifikimit të operacioneve dhe në proceset e menaxhimit të krizave, çka pasqyrohet në një sërë dokumentesh zyrtare, të miratuara nga OKB-ja, NATO-ja, OSBE-ja dhe BE-ja. Të gjithë këta organizma vlerësojnë pjesëmarrjen e grave në të gjitha fazat e operacioneve dhe misioneve të ndërmarra prej tyre për ruajtjen dhe garantimin e paqes dhe sigurisë në botë. Duke pasur këtë në konsideratë, këto organizata ndërkombëtare promovojnë dhe mbështesin parimet e Rezolutës 1325 të KSOKB-së dhe rezolutave të tjera të lidhura me të.

BE-ja ka kërkuar vazhdimisht zbatimin e plotë të agjendës për gratë, paqen e sigurinë të përcaktuar në Rezolutën 1325 dhe rezolutat simotra, veçanërisht nevojën për të luftuar dhunën kundër grave në situata konflikti dhe promovimin e pjesëmarrjes së grave në ndërtimin e paqes. Në vitin 2008 Këshilli i Bashkimit Evropian miratoi “Qasjen gjithëpërfshirëse të BE-së mbi RKSOKB-në 1325 dhe 1820 mbi gratë, paqen dhe sigurinë”, që mbulon të gjithë spektrin e instrumenteve të veprimit të jashtëm të BE gjatë gjithë konfliktit vazhdimësi, nga parandalimi i konfliktit në menaxhimin e krizave, ndërtimin e paqes, rindërtimin dhe bashkëpunimin zhvillimor dhe në vitin 2010 miratoi një grup prej 17 treguesish për matjen e arritjeve të vetë BE-së në këtë drejtim.

Shqipëria, si anëtare e NATO-s dhe OSBE-së, nevojitet të ndërmarrë masa për të përmbushur angazhimet nën këto anëtarësime. Gjithashtu, integrimi në BE i vendit është një nga proceset më të rëndësishme për vendin, prandaj qëndrimet dhe angazhimet e BE-së janë, gjithashtu, një referencë me rëndësi edhe për Shqipërinë. Si pjesë e angazhimeve të tilla, në vitin 2017 Republika e Shqipërisë u bë pjesë e Rrjetit të Mesdheut të Grave Ndërmjetëse. Ky rrjet është një iniciativë që synon rritjen e pjesëmarrjes së grave në përpjekjet paqeruajtëse, si dhe caktimin grave ndërmjetësuese nga secili vend, duke pasur në konsideratë se qëndrueshmëria në Mesdhe është parakusht për sigurinë njerëzore në të gjithë rajonin dhe se gratë mund të sjellin njohuri strategjike dhe të kontribuojnë në zgjidhjen e konflikteve dhe qëndrueshmërinë. Kështu, Shqipëria theksoi angazhimin e saj në veprimtari që synojnë zbatimin më të mirë të Rezolutës 1325 dhe të tjerave mbështetëse të saj.

### III. METODOLOGJIA

Plani i Veprimit është hartuar përmes një procesi konsultimi ku kanë marrë pjesë përfaqësues të institucioneve shtetërore, organizatave të shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtarë.

Metodologjia për hartimin e Planit të Veprimit konsistoi në:

- *Vlerësim pararendës të situatës* së adresimit të agjendës grujaja dhe paqja e siguria në vendin tonë;

- *Seminare ndërgjegjësuere* me institucione të ndryshme, përfshirë edhe ato të linjës dhe përfaqësues të shoqërisë civile, si dhe organizata ndërkombëtare;

- *Trajnime* me institucione të ndryshme, përfshirë edhe ato të linjës dhe përfaqësues të shoqërisë civile, si dhe organizata ndërkombëtare;

- *Takime dhe veprimtari* të ndryshme me organizma të shoqërisë civile, si dhe me “Koalicionin ‘Rezoluta 1325’” krijuar nga vetë shoqëria civile;

- *Takime jozyrtare koordinuese* në nivel teknik dhe politik, me qëllim hartimin e një plani kombëtar veprimi për zbatimin e Rezolutës 1325. Në këto takime kanë marrë pjesë përfaqësues nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Policia e Shtetit, prezenca e OSBE-së në Shqipëri, delegacioni i BE-së, *UN Women*, Shoqata e Grave me Probleme Sociale edhe si anëtare e “Koalicionit për Rezolutën 1325”, AËEN - Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri, si dhe Ambasada e Vendeve të Ulëta në Republikën e Shqipërisë;

- *grup pune* me përfaqësues nga institucionet hartuese të këtij Planit Veprimi në bashkëpunim me përfaqësues të shoqërisë civile.

Rezultat i kësaj pune dhe kryesisht i angazhimit të grupit të punës me përfaqësues të institucioneve hartuese të Planit të Veprimit ishte rënia dakord për fillimin e hartimit të një projektplani kombëtar veprimi, me qëllim zbatimin e Rezolutës 1325.

Plani i Veprimit synon arritjen e një shoqërie shqiptare ku *gratë kanë një rol të përforcuar dhe janë pjesëmarrëse aktive në ruajtjen e paqes, parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve*, sikurse dhe një shoqëri kontribuese në nivel ndërkombëtar në garantimin e të drejtave të grave të përfshira në situata konfliktuale. Plani i Veprimit përshkruan konkretisht objektivat, institucionet përgjegjëse, tregues të matjes dhe afatet e zbatimit, si dhe



përfshin listën e aktiviteteve. Objektivat kryesorë janë të lidhur ngushtësisht me përmirësimin e dokumenteve të politikave dhe rritjen e ndërgjegjësimit për Rezolutën 1325, rritjen e pjesëmarrjes së grave në fushën e sigurisë brenda e jashtë vendit, krijimin e një kuadri rregullator dhe kapaciteteve që mundësojnë një mbrojtje dhe rehabilitim më të mirë të grave në fushën e paqes dhe sigurisë, si dhe marrjen e masave për një monitorim dhe raportim më të mirë të Rezolutës 1325.

#### IV. VIZIONI DHE MISIONI

**Vizioni:** një shoqëri shqiptare ku gratë kanë një rol të përforcuar dhe janë pjesëmarrëse aktive në ruajtjen e paqes, parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve, si dhe një shoqëri me kontribut të qëndrueshëm në nivel ndërkombëtar në garantimin e të drejtave të grave të përfshira në situata konfliktuale.

**Misioni:** rritja e përfaqësimit dhe e angazhimit të grave në sektorin e sigurisë, duke reduktuar stereotipat gjinorë lidhur me përfshirjen e grave në proceset dhe pozitat vendimmarrëse në fushën e sigurisë dhe përforsimi i kontributit të vendit në një politikë ndërkombëtare garantuese të të drejtave të grave e vazhate të përfshira në situata konfliktuale dhe postkonfliktuale.

#### V. OBJEKTIVAT E POLITIKËS

Ky Plan Ndërinstitucional Veprimi bazohet në aktet ndërkombëtare të miratuara me qëllim arritjen e barazisë gjinore dhe pjesëmarrjen e gruas në jetën publike e politike, të ratifikuara edhe nga Republika e Shqipërisë, përfshirë: Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAË), 1979, Deklaratën e Pekinit dhe Platforma për Veprim e miratuar në Konferencën e Katërt Botërore mbi Gratë, 1995; Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara, 2010 dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara, 2015, të cilët theksojnë qartë se paqja dhe stabiliteti janë parakusht për zhvillimin dhe prosperitetin. Gjithashtu, Plani i Veprimit bazohet në dokumentet e politikave në vend që nxisin barazinë gjinore dhe përfshirjen e grave në jetën politike e publike në vend, ndër të tjera edhe në sektorin e sigurisë, si:

- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Plani i Veprimit 2016–2020;
- Strategjia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në FA 2015–2019;

- Strategjia e Rendit Publik 2015–2020,

të cilat adresojnë, ndër të tjera, edhe detyrimet që duhet të përmbushin vendet anëtare të OKB-së për zbatimin e Rezolutës 1325.

**Objektivi kryesor** i këtij Plani Veprimi është zbatimi dhe monitorimi i Rezolutës 1325 përmes promovimit të saj në çdo nivel: vendor, përmes parandalimit të çdo situatë krize, si dhe forcimit të ndërgjegjësimit gjinor të popullatës; kombëtar, si pjesë e programit të qeverisë; si dhe ndërkombëtar, përmes përfshirjes aktive të vendit në aktivitetet ndërkombëtare. Ky Plan Veprimi synon konsolidimin e arritjeve ekzistuese dhe vënien në zbatim të masave me objektiv të qartë dhe konkret përmirësimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e pozicionit të grave në sektorin e sigurimit dhe rritjen e rolit të tyre për paqen dhe sigurimin, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj.

Objektivat kryesorë janë të lidhur ngushtësisht me:

- Përmirësimin e dokumenteve të politikave dhe rritjen e ndërgjegjësimit për Rezolutën 1325;
- Rritjen e pjesëmarrjes së grave në fushën e sigurisë brenda e jashtë vendit;
- Krijimin e një kuadri rregullator dhe kapacitete që mundësojnë një mbrojtje dhe rehabilitim më të mirë të grave në fushën e paqes dhe sigurisë;
- Marrjen e masave për një monitorim dhe raportim më të mirë të Rezolutës 1325.

Masat që vendi synon të realizojë përmes këtij Plani Veprimi përfshijnë:

- Inkurajimin e këmbimit të eksperiencës në nivele të ndryshme rajonale, kombëtare, dhe ndërkombëtare;
- Bashkëpunimin me shoqërinë civile për zbatimin e Rezolutës 1325;
- Adresimin me aktivitete të përbashkëta për rritjen e ndërgjegjësimit të rolit të gruas në ruajtjen e paqes dhe adresimin e situatave postkonflikt: debate publike, fushata, tryeza të rrumbullakëta dhe forma të tjera të informimit publik;
- Rritjen e përfshirjes dhe e rolit të gruas në politikat e sigurisë dhe pjesëmarrjen e eksperteve gra në aktivitetet politike në sigurinë paqeruajtëse, bashkëpunimin rajonal në misionet paqeruajtëse etj., si dhe forcimin e kapaciteteve në këtë drejtim;
- Krijimin e një sistemi raportimi të zbatimit të Planit, si dhe fillimin e punës për hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Zbatimin e Rezolutës 1325;



- Nxijtjen e interesit të përgjithshëm për Rezolutën 1325.

**Fusha e politikës 1. Përmirësimi i dokumenteve të politikave dhe rritja e ndërgjegjësimit për agjendën GPS**

**Objektivi 1.1 Forcimi i perspektivës gjinore përmes rregullave vendëse të funksionimit në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes, dhe të pjesëmarrjes në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare për zbatimin e Rezolutës 1325**

Masat:

1. Rishikimi i rregullave të brendshme ekzistuese në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes lidhur me zbatimin e perspektivës gjinore, në përputhje me zbatimin e Rezolutës 1325

- Institucionet: MB-ja dhe MM-ja;

- Afati: 2018–2020.

2. Integrimi i perspektivës gjinore në aktivitetet ndërkombëtare të vendit dhe raportimi i pjesëmarrjes në këto aktivitete edhe në këndvështrim gjinor

- Institucionet: MEPJ-ja (institucion udhëheqës), MB-ja, MM-ja, MSHMS-ja dhe OSHC-ja të specializuara për Rezolutën 1325;

- Afati: 2018–2020.

3. Fushata ndërgjegjësimi për njohjen me të drejtat e grave dhe legjislacionin për barazinë gjinore, dhunën, paqen dhe sigurinë

- Institucionet: MEPJ-ja, MB-ja, MSHMS-ja, MM-ja dhe OSHC-ja të specializuara për Rezolutën 1325;

- Afati: 2018–2020.

4. Përfaqësimi i punonjësve të policisë në konferenca/punëtori, si dhe në Konferencën e 7-tëvjetore të Grave në Polici, si dhe në Konferencën Vjetore të Shoqatës Ndërkombëtare të Grave Police

- Institucionet: MB-ja;

- Afati: 2018–2020.

5. Përfaqësimi i ushtarakeve femra në strukturat e FA-së dhe operacionet paqeruajtëse jashtë vendit, respektivisht në konferenca dhe seminare

- Institucionet: MM-ja;

- Afati: 2018–2020.

**Objektivi 1.2 Integrimi i perspektivës gjinore në programet e edukimit për zbatimin e Rezolutës 1325**

Masat:

1. Inkurajimi i pjesëmarrjes së grave në të gjitha format e edukimit lidhur me Rezolutën 1325

- Institucionet: MEPJ-ja, MB-ja, MSHMS-ja, MM-ja dhe OSHC-ja të specializuara për Rezolutën 1325;

- Afati: 2018–2020.

2. Trajnime, në bashkëpunim me organizatat jofitimprurëse me fokus të çështjet gjinore në operacionet ushtarake, trajtimin e situatave postkonfliktuale, dhunën kundër grave e vajzave, identifikimin e nevojave të veçanta vendore etj.

- Institucionet: MEPJ-ja, MB-ja, MM-ja dhe OSHC-ja të specializuara për Rezolutën 1325 - Operation 1325, AËEN dhe AËSP;

- Afati: 2018–2020.

3. Trajnime për ndihmën humanitare, trafikimin etj.

- Institucionet: MEPJ-ja, MB-ja dhe MM-ja;

- Afati: 2018–2019.

4. Studim, në bashkëpunim me ICITAP-in dhe Fakultetin e Shkencave Sociale, UT-në në lidhje me krimet seksuale në vend, me fokus ndërgjegjësimin e komunitetit për raportimin e këtyre rasteve

- Institucionet: MB-ja, ICITAP-i, OSHC-ja e Fakulteti i Shkencave Sociale, UT-ja;

- Afati: 2018–2020.

5. Rishikimi i kurrikulave të Akademisë së Forcave të Armatosura, Shkollës Bazë së Policisë dhe trajnime afatshkurtra të Akademisë së Sigurisë dhe përfshirja e elementëve gjinorë dhe agjendës GPS në to

- Institucionet: MB-ja, MM-ja dhe OSHC-ja të specializuara për Rezolutën 1325;

- Afati: 2018–2020.

6. Fuqizimi i kapaciteteve profesionale të Policisë së Shtetit për perspektivën gjinore në policim dhe me fokus të ngacmimet seksuale

- Institucionet: MB-ja dhe OSHC-ja të specializuara për Rezolutën 1325, mbështetur nga OSCE-ja /ODIHR-i;

- Afati: 2018–2020.

7. Fuqizimi i kapaciteteve profesionale të punonjësve të policisë në hetimin e krimeve seksuale

- Institucionet: MB-ja dhe OSHC-ja të specializuara për Rezolutën 1325, mbështetur nga OSCE-ja /ODIHR-i;

- Afati: 2018–2020.

8. Fuqizimi i kapaciteteve profesionale të punonjësve të policisë për hetimin e krimeve të ndodhura ndaj personave për shkak të orientimit seksual (krimet e urrejtjes)



- Institucionet: MB-ja dhe OSHC-ja të specializuara për Rezolutën 1325

- Afati: 2018–2020

**Objektivi 1.3 Rritja e ndërgjegjësimit për Rezolutën 1325 dhe zbatimin e saj**

Masat:

1. Aktivitete ndërgjegjëse me gratë parlamentare për njohjen e Rezolutës 1325 dhe rritjen e numrit të grave në strukturat e përhershme parlamentare që adresojnë politikën e sigurisë

- Institucionet: Kuvendi dhe OSHC-ja të specializuara për Rezolutën 1325;

- Afati: 2018–2020.

2. Aktivitete ndërgjegjëse me njësi të vetëqeverisjes vendore për njohjen e Rezolutës 1325 dhe zbatimin e saj edhe në nivel vendor

- Institucionet: njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe OSHC-ja të specializuara për Rezolutën 1325/koalicioni për Rezolutën 1325, AËSP, AËEN, Operation 1325;

- Afati: 2018–2020.

3. Aktivitete ndërgjegjëse me median për njohjen e Rezolutës 1325 dhe zbatimin e saj

- Institucionet: operatorë të medias dhe OSHC-ja të specializuara për Rezolutën 1325/Koalicioni për Rezolutën 1325, AËSP, AËEN, Operation 1325;

- Afati: 2018–2020.

4. Realizimi i projekteve të posaçme, me qëllim edukimin e komunitete vendore, grave në profesione të ndryshme, të shoqërisë civile, lidhur me rolin e grave në mbrojtjen e të drejtave të tyre pas situatave të konflikteve, si dhe njohjen e eksperiencave të rehabilitimit pas situatave të konflikteve apo luftërave për pavarësi nga vende të tjera

- Institucionet: MEPJ-ja, MB-ja, MM-ja, MSHMS-ja dhe OSHC-ja të specializuara për Rezolutën 1325;

- Afati: 2018–2020.

5. Takime ndërgjegjëse mbi rëndësinë e përqasjes gjinore të koordinatorëve të transparencës në njësitë e vetëqeverisjes vendore

- Institucionet: MSHMS-ja, ministri të tjera të linjës, NJVQV-të, OSHC-ja të specializuara për Rezolutën 1325 dhe donatorët;

- Afati: 2018–2020.

6. Takime ndërgjegjëse të administratoreve lokale mbi integrimin gjinor

- Institucionet: NJVQV-ja, MSHMS-ja dhe OSHC-ja të specializuara për Rezolutën 1325

- Afati: 2018–2020

7. Fushata ndërgjegjësimi për njohjen me të drejtat e grave dhe legjislacionin për barazinë gjinore, dhunën, paqen dhe sigurinë

- Institucionet: MSHMS-ja, si dhe OSHC-ja të specializuara për Rezolutën 1325;

- Afati: 2018–2020.

8. Fushata ndërgjegjësimi kombëtare në mbështetje të fushatave ndërkombëtare

Institucionet: MSHMS-ja, MEPJ-ja, MB-ja, MM-ja dhe OSHC-ja të specializuara për Rezolutën 1325;

Afati: 2018–2020.

**Fusha e politikës 2. Pjesëmarrja**

**Objektivi 2.1 Përfshirja e balancës gjinore në aktivitetet e sektorit të sigurisë**

Masat:

1. Promovimi/emërimi i punonjësve të policisë dhe Forcave të Armatosura në role drejtuese dhe fuqizimi i kapaciteteve të tyre si drejtuese në Polici dhe Forca të Armatosura

- Institucionet: MB-ja, MEPJ-ja dhe MM-ja;

- Afati: 2018–2020.

2. Rritja e numrit të grave, si gjinia e nënpërfaqësuar, në sistemin e karrierës të sektorit të sigurisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi

- Institucionet: MB-ja, MEPJ-ja dhe MM-ja;

- Afati: 2018–2020.

3. Promovimi i karrierës/rritjes në gradë të punonjësve gra të policisë që shërbejnë në struktura të ndryshme, përfshirë strukturat e hetimit të krimit

- Institucionet: MB-ja;

- Afati: 2018–2020.

4. Rritja e numrit të punonjësve gra në strukturat operacionale të hetimit të krimit

- Institucionet: MB-ja;

- Afati: 2018–2020.

5. Rritja e pjesëmarrjes së femrave në Forcat e Armatosura në misionet paqeruajtëse jashtë vendit

- Institucionet: MM-ja;

- Afati: 2018–2020.

**Objektivi 2.2 Rritja e përfaqësimit të grave në aktivitete vendimmarrëse dhe procese që lidhen në sigurinë dhe ruajtjen e paqes**

Masat:

1. Rritja e numrit të grave si atashe ushtarake në përfaqësitë diplomatike dhe ambasadat e Republikës së Shqipërisë dhe në organizatat



ndërkombëtare, që adresojnë çështje të sigurisë ndërkombëtare

- Institucionet: MEPJ-ja, MB-ja dhe MM-ja;
- Afati: 2018–2020.

2. Rritja e numrit të grave të nivelit të lartë diplomatik si ambasadore në misionet e përhershme dhe ambasadat e RSH-së dhe organizatat ndërkombëtare që adresojnë çështje të sigurisë ndërkombëtare

- Institucionet: MEPJ-ja;
- Afati: 2018–2020.

3. Emërimi apo caktimi i grave në pozicione drejtuese në organizatat ndërkombëtare që adresojnë çështje të sigurisë

- Institucionet: MEPJ-ja dhe MM-ja;
- Afati: 2018–2020.

4. Rritja e numrit të grave në nivele vendimmarrëse në mekanizmat për parandalimin, menaxhimin dhe zgjidhjen e konflikteve në nivel vendor, rajonal dhe qendror.

- Institucionet: MEPJ-ja, MB-ja, MM-ja dhe OSHC-ja të specializuara për Rezolutën 1325;
- Afati: 2018–2020.

**Fusha e politikës 3. Mbrojtja dhe rehabilitimi**

**Objektivi 3.1 Promovimi i mbrojtjes së grave dhe vajzave viktima të dhunës me bazë gjinore lidhur kjo me situatat e konflikteve të armatosura dhe postkonflikte të tilla në vende të tjera**

Masat:

1. Rishikimi i rregullave të brendshme për të përfshirë masa disiplinore për ushtruesit e dhunës me bazë gjinore mes personelit paqeruajtës

- Institucionet: MM-ja, MEPJ-ja;
- Afati: 2018–2020.

2. Rritja e ndërgjegjësimit për zero tolerancë ndaj shfrytëzimit seksual

- Institucionet: MEPJ-ja, MB-ja, MM-ja dhe MSHMS-ja;
- Afati: 2018–2020.

**Objektivi 3.2 Zbatimi i mbrojtjes së grave dhe vajzave shqiptare viktima të luftës dhe me qëllim rehabilitimin pas konflikteve**

Masat:

1. Mbledhja dhe analizimi i informacioneve për gratë dhe vajzat në luftë dhe i ndikimit të luftës dhe të situatave konfliktuale te gratë dhe vajzat në RSH

- Institucionet: MB-ja dhe MM-ja;
- Afati: 2018–2020.

2. Rritja e ndërgjegjësimit për minat, bombat, eksplozivët e tjerë të mbetura pas situatave konfliktuale

- Institucionet: MB-ja dhe MM-ja;
- Afati: 2018–2020.

3. Rritja e ndërgjegjësimit të grave e vajzave për mbledhjen e armëve të shpërndara në kundërshtim me ligjin në popullatë dhe fushata për mbledhjen e tyre

- Institucionet: MB-ja dhe MM-ja;
- Afati: 2018–2020.

**Fusha e politikës 4. Zbatimi dhe monitorimi i Rezolutës 1325**

**Objektivi 4.1 Përmirësimi i bashkëpunimit për zbatimin dhe monitorimin e Rezolutës 1325 (dhe të tjerave të lidhura me të)**

Masat:

1. Inkurajimi i këmbimit të eksperiencës në nivel kombëtar lidhur me zbatimin e rezolutës 1325 dhe të tjerave të lidhura me të, përmes organizimit të konferencave apo aktiviteteve të tjera

- Institucionet: MEPJ-ja, MB-ja, MM-ja dhe OSHC-ja të specializuara për Rezolutën 1325;
- Afati: 2018–2020.

2. Inkurajimi i këmbimit të eksperiencës në nivel ndërkombëtar e rajonal lidhur me zbatimin e Rezolutës 1325 (dhe të tjerave të lidhura me të)

- Institucionet: MEPJ-ja, MB-ja, MM-ja dhe OSHC-ja të specializuara për Rezolutën 1325/AËSP, AËEN, Operation 1325;
- Afati: 2018–2020.

3. Përfshirja e elementeve të agjendës GPS në raportimet rajonale dhe ndërkombëtare të vendit

- Institucionet: MEPJ-ja, MB-ja, MSHMS-ja dhe MM-ja;
- Afati: 2018–2020.

4. Hartimi i raporteve të monitorimit nga organizata të shoqërisë civile që mbështesin Rezolutën 1325, me qëllim zbatimin sa më të mirë të saj

- Institucionet: MEPJ-ja, MB-ja, MM-ja dhe OSHC-ja të specializuara për Rezolutën 1325/koalicioni për Rezolutën 1325;
- Afati: 2018–2020.

**Objektivi 4.2 Mbështetja e zbatimit të plotë të Rezolutës 1325 (dhe të tjerave të lidhura me të)**



Masat:

1. Ngritja e grupit të punës për rishikimin e planit aktual dhe hartimin e Planit Kombëtar për zbatimin e Rezolutës 1325

- Institucionet: MEPJ-ja, MB-ja, MM-ja, MSHMS-ja, në bashkëpunim me OSHC-në të specializuara për Rezolutën 1325;

- Afati: fundi i vitit 2018.

## VI. BURIME FINANCIARE

### I. BURIMET FINANCIARE

Plani Ndërinstitucional i Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 të KSOKB-së do të zbatohet në periudhën 2018–2020. Për të mbështetur zbatimin e tij është parashikuar kostoja për secilin: veprimtari, objektiv specifik, synim strategjik dhe fushë. Kostoja e përgjithshme për realizimin e PKV-së është rreth **280.7 milionë lekë** ose afërsisht **2.2 milionë euro**<sup>6</sup>.

Kostimi i planit të veprimit u realizua mbështetur në koston e secilit aktivitet të pasqyruar në planin e veprimit dhe kohështirjen e tij, si dhe indikatorët dhe treguesit për monitorimin e planit të veprimit. Metodologjia e përdorur për kostimin është një metodologji e kombinuar, pasi plani përfshin disa sektorë dhe institucione, si dhe larmia e aktiviteteve është e madhe.

Metodologjia kryesore e përdorur është kostimi i bazuar në aktivitete, por ndërkohë janë marrë parasysh për shumë veprimtari shpenzimet mesatare sipas PBA 2018–2020 për aktivitete që janë përfshirë në buxhet dhe për aktivitete të ngjashme, është mbajtur parasysh niveli i pagave në sektorët e përfshirë në planin e veprimit etj. Për llogaritjen e shpenzimeve për aktivitetet kryesore është vepruar si më poshtë:

Në llogaritjen e shpenzimeve për trajnime është mbajtur në konsideratë kostoja e trajnimit të vazhduar. Si kosto për njësi janë përdorur kostot e trajnimit të strukturave të policisë<sup>7</sup> në MB dhe/ose kostot e aplikuara për trajnime të ngjashme në të shkuarën.

Për atë pjesë të aktiviteteve ku informacioni nuk ishte i plotë është ndjekur metoda e vlerësimit për analogji ose, me fjalë të tjera, janë marrë në konsideratë shpenzimet e bëra për aktivitete të ngjashme në të shkuarën.

Për të realizuar buxhetimin u konsultua gjithashtu, dokumenti i PBA 2018–2020, buxheti

për vitin 2018, buxhete për aktivitete të ngjashme të zbatuara nga institucione, donatorë apo organizata jofitimprurëse në të shkuarën.

Plani i Veprimit përfshin një buxhet për zbatimin e çdo veprimtarie. Në varësi të llojit të veprimtarisë, Plani i Veprimit ka specifikuar burimet e financimit:

1. *Financimin nga buxheti* (buxheti i ministrive të linjës të përfshira në këtë Plan Veprimi si institucione përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve;

2. *Financimi nga donatorët* për ato veprimtari, kostot e të cilave mbulohen nga fonde të donatorëve, pavarësisht nëse kanalizohet përmes buxhetit ose organizatave të shoqërisë civile që ofrojnë shërbimet në fusha të caktuara;

3. *Nevojat për fonde*, për ato aktivitete që nuk janë identifikuar të buxhetuara në buxhetin afatmesëm.

Buxheti i përgjithshëm për zbatimin e PV-së është reflektuar në disa forma:

- Buxheti i përgjithshëm sipas viteve për secilin aktivitet, objektiv specifik, fushë strategjike dhe burimeve të financimit<sup>8</sup>;

- Buxheti i detajuar sipas aktiviteteve, treguesve, burimeve të financimit dhe institucioneve përgjegjëse<sup>9</sup>;

- Buxheti i kërkuar për zbatimin e planit të veprimit ka një shtrirje pak a shumë uniforme për periudhën 2019–2020 (fig. 1);

- Buxheti për 2018–ën mbulon shpenzimet për aktivitetet e planifikuara.


<sup>6</sup> Kursi i këmbimit: 1 euro = 133 lekë.

<sup>7</sup> Sipas PBA 2018–2020.

<sup>8</sup> Për të dhëna të detajuara shih shtojcën e buxhetit.

<sup>9</sup> Për të dhëna të detajuara shih shtojcën e buxhetit.

Figura 1. Buxheti në % për periudhën 2018–2020



- Nga llogaritjet rezulton që buxheti i shtetit me burimet në dispozicion mund të mbulojë 83.3% të kostove së përgjithshme për zbatimin e planit të veprimit, ndërsa 2.6% janë fonde të alokuara nga donatorë për aktivitete specifike.

- Tabela 1 paraqet buxhetin e përgjithshëm dhe nevojat për financim për periudhën 2018–2020.

- Buxhetin më të madh e kërkon fusha 2, “Pjesëmarrja”, rreth 80.04%.

- Nevojat më të mëdha për fonde shtesë janë në fushën 1, “Forcimi i dokumenteve të politikave dhe rritja e ndërgjegjësimit për agjendën GPS”, me rreth 52.3%. Mbështetje kërkohet kryesisht për fushatat e ndërgjegjësimit.

- Nevojat për fonde janë në masën 14.1% të kostos totale ose 39.7 milionë lekë.



Tabela 1. Kostot dhe burimet e financimit 2018–2020

| PËRSHKRIMI                                                                                             |                      |                      |                       |                       | FINANCUAR NGA         |                     |                       | Nevojat për          | Llogaria e Shpenzimeve |                      |             |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------|----------------------|-----------------------|-----------------------|-----------------------|---------------------|-----------------------|----------------------|------------------------|----------------------|-------------|
| OBJEKTIVAT, AKTIVITETET                                                                                | VITI 2018            | VITI 2019            | VITI 2020             | TOTALI                | Qeveria               | Donatorët           | Totali                | Fonde LEKË           | 600-601                | 602-608              | 230-231     |
| Fusha e politikës 1. Forcimi i dokumenteve të politikave dhe rritja e ndërgjegjësimit për agjendën GPS | 6,259,240.00         | 14,736,640.00        | 12,181,640.00         | 33,177,520.00         | 5,059,920.00          | 7,342,600.00        | 12,402,520.00         | 20,775,000.00        | 3,465,150.00           | 29,712,370.00        | 0.00        |
| Fusha e politikës 2: Pjesëmarrja                                                                       | 45,456,000.00        | 76,508,000.00        | 103,660,000.00        | 225,624,000.00        | 225,624,000.00        | 0.00                | 225,624,000.00        | 0.00                 | 225,624,000.00         | 0.00                 | 0.00        |
| Fusha e Politikës 3: Mbrojtja dhe rehabilitimi                                                         | 519,960.00           | 4,719,960.00         | 4,719,960.00          | 9,959,880.00          | 1,559,880.00          | 0.00                | 1,559,880.00          | 8,400,000.00         | 1,559,880.00           | 8,400,000.00         | 0.00        |
| Fusha e Politikës 4 - Zbatimi dhe monitorimi i Rezolutës 1325                                          | 4,574,836.00         | 3,722,840.00         | 3,722,840.00          | 12,020,516.00         | 1,520,516.00          | 0.00                | 1,520,516.00          | 10,500,000.00        | 4,920,516.00           | 7,100,000.00         | 0.00        |
| <b>TOTAL (1+2+3+4+5)</b>                                                                               | <b>56,810,036.00</b> | <b>99,687,440.00</b> | <b>124,284,440.00</b> | <b>280,781,916.00</b> | <b>233,764,316.00</b> | <b>7,342,600.00</b> | <b>241,106,916.00</b> | <b>39,675,000.00</b> | <b>235,569,546.00</b>  | <b>45,212,370.00</b> | <b>0.00</b> |



## VII. LLOGARIDHËNIA, MONITORIMI DHE ANALIZA VLERËSUESE E PLANIT TË VEPRIMIT

Plani i Veprimit është një dokument ndërsektorial politikash specifik që adreson aspektet gjinore në lidhje me fushën e sigurisë dhe të paqes. Procesi i monitorimit të zbatimit të këtij do të jetë një proces ndërsektorial, i cili po ashtu do të ushqejë orientimin e politikave në Sistemin e Planifikimit të Integruar (SPI). Raportet në kuadër të këtij Plani Veprimi do të dërgohen pranë Grupit të Integruar të Menaxhimit të Politikave, përkatësisht nëngrupit tematik për Sektorin e Punësimit dhe atë Social, i ngritur me urdhër të Kryeministrit, nr. 129, datë 21.9.2015, “Për marrjen e masave institucionale dhe operacionale për zbatimin e qasjes sektoriale dhe krijimin e grupeve të menaxhimit të integruar të politikave”. Raporti vjetor paraqitet për miratim pranë Këshillit të Barazisë Gjinore.

Në nivel operacional, përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Planit të Veprimit do të jenë nëpunësit e barazisë gjinore në ministrinë e linjës dhe institucionet e ngarkuara me zbatimin këtij Plani Veprimi, të cilët mbledhin të dhëna dhe identifikojnë boshllëqet e informacionit që nevojitet. MSHMS-ja ka rol koordinues dhe bashkërendues mbi ecurinë e zbatimit. Plani i Veprimit parashikon botimin e progresraporteve gjashtëmujore dhe mbështetjen për raportet monitoruese të koalicionit të organizatave të shoqërisë civile për Rezolutën 1325 të angazhuara me agjendën grua, paqja, siguria.

Në nivel politikash, monitorimi i këtij Plani Veprimi do të realizohet përmes një grupi

ndërinstitucional të ngritur me përfaqësues të lartë politikë të Ministrisë së Mbrojtjes, të Brendshme, për Evropën dhe Punët e Jashtme, si dhe të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale që zhvillon takime gjashtëmujore, me koordinimin e MSHMS-së. Në takimet në nivelin politik merr pjesë edhe një përfaqësues i koalicionit të OSHC-ve për agjendën grua, paqja, siguria. Monitorimi dhe vlerësimi i këtij Plani Veprimi do të realizohet nga një Grup Zbatimi dhe Koordinimi (GZK), i cili do të monitorojë, do të vlerësojë dhe do të raportojë lidhur me Planin e Veprimit. GZK-ja përbëhet nga përfaqësues teknikë të ministrive të linjës, institucioneve përgjegjëse për zbatimin e këtij Plani Veprimi, si dhe përfaqësues i koalicionit të organizatave të shoqërisë civile për Rezolutën 1325 të angazhuara me agjendën grua, paqja, siguria. MSHMS-ja do të koordinojë procesin e mbledhjes së të dhënave nga të gjithë nëpunësit gjinorë në institucionet e përfshira.

Cikli i vlerësimit të këtij Plani Veprimi përfshin:

- vlerësimin formues të progresit dhe rishikimin e veprimeve të parashikuara në fund të vitit 2018;

- rishikimin dhe përditësimin masave, duke konsideruar edhe planifikimet buxhetore deri në vitin 2020;

- vlerësimin përfundimtar në fund të 2020-ës, që do të përfshijë edhe çdo çështje të paadresuar dhe zhvillimet që mbeten për t'u realizuar dhe mënyrat e adresimit në vijim.



## VIII. LISTA E AKTIVITETEVE

| Nr.                                                                                                                                                                                                                         | Aktiviteti                                                                                                                                                                                  | Institucioni përgjegjës                                                      | Indikatorët                                                                                                                        | Afatet kohore | Efektet financiare dhe burimet në lekë |                    |                   |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------|----------------------------------------|--------------------|-------------------|
|                                                                                                                                                                                                                             |                                                                                                                                                                                             |                                                                              |                                                                                                                                    |               | Shpenzime korrente                     | Shpenzime kapitale | Nevojat për fonde |
| Fusha 1. Forcimi i dokumenteve të politikave dhe rritja e ndërgjegjësimit për agjendën GPS                                                                                                                                  |                                                                                                                                                                                             |                                                                              |                                                                                                                                    |               |                                        |                    |                   |
| Objektivi specifik 1.1 Forcimi i perspektivës gjinore përmes rregullave vendëse të funksionimit në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes dhe pjesëmarrjes në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare për zbatimin e Rezolutës 1325 |                                                                                                                                                                                             |                                                                              |                                                                                                                                    |               |                                        |                    |                   |
| 1.1.1                                                                                                                                                                                                                       | Rishikimi i rregullave të brendshme ekzistuese në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes lidhur me zbatimin e perspektivës gjinore në përputhje me zbatimin e Rezolutës 1325.                      | MB-ja dhe MM-ja                                                              | Rregullat e brendshme të MEPJ-së, MM-së dhe MB-së, të rishikuara, përfshijnë rregulla ku të reflektohen kërkesat e Rezolutës 1325  | 2018          | 371,400.00                             | 0.00               | 0.00              |
| 1.1.2                                                                                                                                                                                                                       | Integrimi perspektivës gjinore në aktivitetet ndërkombëtare të vendit dhe raportimi i pjesëmarrjes në këto aktivitete edhe në këndvështrim gjinor.                                          | MEPJ-ja (institucion udhëheqës), MB-ja, MM-ja, MSHMS-ja                      | Raportimet e depozituara në emër të RSH-së                                                                                         | 2018–2020     | 563,520.00                             | 0.00               | 0.00              |
| 1.1.3                                                                                                                                                                                                                       | Fushata ndërgjegjësimi për njohjen me të drejtat e grave dhe legjislacionin për barazinë gjinore, dhunën, paqen dhe sigurinë.                                                               | MEPJ-ja, MB-ja, MSHMS-ja, MM-ja, OSHC-ja të specializuara për Rezolutën 1325 | Numri i fushatave, nr. i institucioneve pjesëmarrëse dhe nr. i personave të ndërgjegjësuar (3 fushata ndërgjegjësuare nga OSHC-ja) | 2018–2020     | 3,801,000.00                           | 0.00               | 3,801,000.00      |
| 1.1.4                                                                                                                                                                                                                       | Përfaqësimi i punonjësve të policisë në konferenca/punëtori, si dhe në Konferencën e 7-vjetore të Grave në Polici, si dhe në konferencën vjetore të Shoqatës Ndërkombëtare të Grave Police. | MB-ja                                                                        | Numri i pjesëmarrësve në konferencën e 7-të vjetore dhe në konferencën vjetore të shoqatës                                         | 2018          | 1,872,000.00                           | 0.00               | 0.00              |
| 1.1.5                                                                                                                                                                                                                       | Përfaqësimi ushtarakeve femra në strukturat e FA-së dhe operacionet paqeruajtëse jashtë vendit, respektivisht në konferenca dhe seminare.                                                   | MM-ja                                                                        | Numri i femrave pjesëmarrëse në Forcat e Armatosura i rritur me ...%                                                               | 2018–2020     | 30,816,000.00                          | 0.00               | 0.00              |



| <b>Objektivi specifik 1.2 Integrimi i perspektivës gjinore në programet e edukimit për zbatimin e Rezolutës 1325</b> |                                                                                                                                                                                                                                       |                                                                                       |                                                                                                                                          |           |              |      |              |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|--------------|------|--------------|
| 1.2.1                                                                                                                | Inkurajimi i pjesëmarrjes së grave në të gjitha format e edukimit lidhur me Rezolutën 1325.                                                                                                                                           | MEPJ-ja, MB-ja, MSHMS-ja, MM-ja dhe OSHC-ja të specializuara për Rezolutën 1325       | Nr. i aktiviteteve edukuese për Rezolutën 1325, nr. i institucioneve pjesëmarrëse dhe nr. i personave të ndërgjegjësuar.                 | 2018–2020 | 600,000.00   | 0.00 | 600,000.00   |
| 1.2.2                                                                                                                | Trajnime, në bashkëpunim me organizatat jofitimprurëse me fokus të çështjet gjinore në operacionet ushtarake, trajtimin e situatave postkonfliktuale, dhunën kundër grave e vajzave, identifikimin e nevojave të veçanta vendore etj. | MEPJ-ja, MB-ja, MM-ja dhe OSHC-ja të specializuara për Rezolutën 1325                 | Numri i trajnimeve, nr. i institucioneve pjesëmarrëse dhe nr. i personave të trajnuar.                                                   | 2018–2020 | 980,000.00   | 0.00 | 980,000.00   |
| 1.2.3                                                                                                                | Trajnime për ndihmën humanitare, trafikimin etj.                                                                                                                                                                                      | MEPJ-ja, MB-ja dhe MM-ja                                                              | Numri i trajnimeve, nr. i institucioneve pjesëmarrëse dhe nr. i personave të trajnuar.                                                   | 2018–2020 | 840,000.00   | 0.00 | 840,000.00   |
| 1.2.4                                                                                                                | Studim, në bashkëpunim me ICITAP-in dhe Fakultetin e Shkencave Sociale, UT-në për krimet seksuale në vend, me fokus ndërgjegjësimin e komunitetit për raportimin e këtyre rasteve.                                                    | MB-ja, ICITAP-i, OSHC-ja dhe Fakulteti i Shkencave Sociale, UT                        | Studimi i botuar: popullimi i databazës së kërkimeve lidhur me krimet seksuale dhe aktivitet për publikimin e rekomandimeve të studimit. | 2018–2020 | 2,300,000.00 | 0.00 | 2,300,000.00 |
| 1.2.5                                                                                                                | Rishikimi i kurrikulave të Akademisë së Forcave të Armatosura, Shkollës Bazë të Policisë, duke përfshirë tema dhe elementë të integritetit gjinor dhe trajnime afatshkurtra të Akademisë së Sigurisë dhe agjendës GPS në to.          | MB-ja, MM-ja dhe OSHC-ja të specializuara për Rezolutën 1325                          | Kurrikulat e rishikuara.                                                                                                                 | 2018–2020 | 4,125,000.00 | 0.00 | 0.00         |
| 1.2.6                                                                                                                | Fuqizimi i kapaciteteve profesionale të Policisë së Shtetit për perspektivën gjinore në policim dhe me fokus të ngacmimit seksual.                                                                                                    | MB-ja dhe OSHC-ja të specializuara për Rezolutën 1325, mbështetur nga OSCE-ja/ODIHR-i | Numri i trajnimeve, nr. i personave të trajnuar.                                                                                         | 2018–2020 | 1,120,000.00 | 0.00 | 1,120,000.00 |



|                                                                                              |                                                                                                                                                                                        |                                                                                                                                            |                                                                                                                                                         |              |            |      |            |
|----------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------|------------|------|------------|
| 1.2.7                                                                                        | Fuqizimi i kapaciteteve profesionale të punonjësve të policisë në hetimin e krimeve seksuale.                                                                                          | MB-ja dhe OSHC-ja të specializuara për Rezolutën 1325, mbështetur nga OSCE-ja/ ODIHR-i                                                     | Numri i trajnimeve, nr. i personave të trajnuar.                                                                                                        | 2018–2020    | 840,000.00 | 0.00 | 840,000.00 |
| 1.2.8                                                                                        | Fuqizimi i kapaciteteve profesionale të punonjësve të policisë për hetimin e krimeve të ndodhura ndaj personave për shkak të orientimit seksual (krimet e urrejtjes).                  | MB-ja dhe OSHC-ja të specializuara për Rezolutën 1325                                                                                      | Numri i trajnimeve, nr. i personave të trajnuar.                                                                                                        | 2018–2020    | 840,000.00 | 0.00 | 840,000.00 |
| <b>Objektivi specifik 1.3 Rritja e ndërgjegjësimit për Rezolutën 1325 dhe zbatimin e saj</b> |                                                                                                                                                                                        |                                                                                                                                            |                                                                                                                                                         |              |            |      |            |
| 1.3.1                                                                                        | Aktivitete ndërgjegjësuere me gratë parlamentare për njohjen e Rezolutës 1325 dhe rritjen e numrit të grave në strukturat e përhershme parlamentare që adresojnë politikat e sigurisë. | Kuvendi dhe OSHC-ja të specializuara për Rezolutën 1325                                                                                    | Numri i aktiviteteve ndërgjegjësuere të zhvilluara, nr. i personave të ndërgjegjësuar, numri i grave të shtuara në strukturat parlamentare të sigurisë. | Shtator 2017 | 85,600.00  | 0.00 | 0.00       |
| 1.3.2                                                                                        | Aktivitete ndërgjegjësuere me njësi të qeverisjes vendore për njohjen e Rezolutës 1325 dhe zbatimin e saj edhe në nivel vendor.                                                        | Njësi të vetëqeverisjes vendore dhe OSHC-ja të specializuara për Rezolutën 1325- Koalicioni për Rezolutën 1325, AËSP, AËEN, Operation 1325 | Numri i aktiviteteve ndërgjegjësuere të zhvilluara, numri i njësive vendore pjesëmarrëse, nr. i personave të ndërgjegjësuar.                            | 2018–2020    | 520,000.00 | 0.00 | 0.00       |
| 1.3.3                                                                                        | Aktivitete ndërgjegjësuere me median për njohjen e Rezolutës 1325 dhe zbatimin e saj.                                                                                                  | Operatorë të medias dhe OSHC-ja të specializuara për Rezolutën 1325 - Koalicioni për                                                       | Numri i aktiviteteve ndërgjegjësuere të zhvilluara, numri i operatorëve të medias pjesëmarrëse, nr. i personave të ndërgjegjësuar.                      | 2018–2020    | 520,000.00 | 0.00 | 520,000.00 |



|       |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |                                                                                                           |                                                                                                                                  |           |              |      |              |
|-------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|--------------|------|--------------|
|       |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | Rezolutën 1325, AËSP, AËEN, Operation 1325                                                                |                                                                                                                                  |           |              |      |              |
| 1.3.4 | Realizimi i projekteve të posaçme me qëllim edukimin e komunitete vendore, si dhe grave në profesione të ndryshme, si dhe të shoqërisë civile, lidhur me rolin e grave në mbrojtjen e të drejtave të tyre pas situatave të konflikteve, si dhe njohjen e eksperiencave të rehabilitimit pas situatave të konflikteve apo luftërave për pavarësi nga vende të tjera. | MEPJ-ja, MB-ja, MM-ja, MSHMS-ja dhe OSHC-ja të specializuara për Rezolutën 1325                           | Numri i projekteve të realizuara, përvojat e këmbëra, nr. i personave përfitues nga këto përvoja dhe aktivitete.                 | 2018–2020 | 6,400,000.00 | 0.00 | 6,400,000.00 |
| 1.3.5 | Takime ndërgjegjëse mbi rëndësinë e përjasjes gjinore të koordinatoreve të transparencës në njësitë e vetëqeverisjes vendore.                                                                                                                                                                                                                                       | MSHMS-ja, ministri të tjera të linjës, NJQV-të, OSHC-ja të specializuara për Rezolutën 1325 dhe donatorët | Numri i aktiviteteve të zhvilluara, përvojat e këmbëra, nr. i personave përfitues nga këto përvoja dhe aktivitete.               | 2018–2020 | 684,800.00   | 0.00 | 0.00         |
| 1.3.6 | Takime ndërgjegjëse të administratoreve lokale mbi integrimin gjinor.                                                                                                                                                                                                                                                                                               | NJQV-ja, MSHMS-ja dhe OSHC-ja të specializuara për Rezolutën 1325                                         | Numri i takimeve të zhvilluara, përvojat e këmbëra, nr. i personave përfitues nga këto përvoja dhe aktivitete.                   | 2018–2020 | 1,027,200.00 | 0.00 | 0.00         |
| 1.3.7 | Fushata ndërgjegjësimi për njohjen me të drejtat e grave dhe legjislacionin për barazinë gjinore, dhunën, paqen dhe sigurinë.                                                                                                                                                                                                                                       | MSHMS-ja ore OSHC-ja të specializuara për Rezolutën 1325                                                  | Numri i fushatave, kohëzgjatja dhe shtrirja, target-grupet e synuara, mesazhet e transmetuara, nr. i personave përfitues nga to. | 2018–2020 | 5,025,000.00 | 0.00 | 0.00         |
| 1.3.8 | Fushata ndërgjegjësimi kombëtare në mbështetje të fushatave ndërkombëtare.                                                                                                                                                                                                                                                                                          | MSHMS-ja ore OSHC-ja të specializuara për Rezolutën 1325                                                  | Numri i fushatave, kohëzgjatja dhe shtrirja, target-grupet e synuara, mesazhet e transmetuara, nr. i personave përfitues nga to. | 2018–2020 | 2,534,000.00 | 0.00 | 2,534,000.00 |



| Fusha e politikës 2. Pjesëmarrja                                                                                                         |                                                                                                                                                                                                                            |                          |                                                                                                    |           |               |      |      |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|---------------|------|------|
| Objektivi specifik 2.1 Përfshirja e balancës gjinore në aktivitetet e sektorit të sigurisë                                               |                                                                                                                                                                                                                            |                          |                                                                                                    |           |               |      |      |
| 2.1.1                                                                                                                                    | Promovimi dhe fuqizimi i punonjësve të policisë dhe Forcave të Armatosura në role drejtuese: nëpërmjet emërimeve në detyra drejtuese të punonjësve të policisë dhe Forcave të Armatosura.                                  | MEPJ-ja, MB-ja dhe MM-ja | Numri i grave të emëruara në pozicione të larta.                                                   | 2018–2020 | 71,280,000.00 | 0.00 | 0.00 |
| 2.1.2                                                                                                                                    | Rritja e numrit të grave, si gjinia e nënpërfaqësuar, në sistemin e karrierës të sektorit të sigurisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.                                                                             | MB-ja, MEPJ-ja dhe MM-ja | Numri i grave të ngritura në detyrë, nivelit që kishin dhe ai më i lartë që morën.                 | 2018–2020 | 35,640,000.00 | 0.00 | 0.00 |
| 2.1.3                                                                                                                                    | Promovimi i karrierës/ecuria në gradë e punonjësve të policisë, si dhe, veçanërisht, e punonjësve që shërbejnë në struktura të ndryshme, të cilat pas edukimit përkatës do të shërbejnë në strukturat e hetimit të krimit. | MB-ja                    | Numri i grave të shtuara në strukturat përkatëse.                                                  | 2018–2020 | 18,540,000.00 | 0.00 | 0.00 |
| Objektivi specifik 2.2 Rritja e përfaqësimit të grave në aktivitete vendimmarrëse dhe procese që lidhen në sigurinë dhe ruajtjen e pages |                                                                                                                                                                                                                            |                          |                                                                                                    |           |               |      |      |
| 2.2.1                                                                                                                                    | Rritja e numrit të grave si atashe ushtarake në përfaqësitë diplomatike dhe ambasadat e Republikës së Shqipërisë dhe në organizatat ndërkombëtare që adresojnë çështje të sigurisë ndërkombëtare.                          | MEPJ-ja, MB-ja dhe MM-ja | Numri i grave të shtuara si atashe.                                                                | 2018–2020 | 19,500,000.00 | 0.00 | 0.00 |
| 2.2.2                                                                                                                                    | Rritja e numrit të grave të nivelit të lartë diplomatik, si ambasadore në misionet e përhershme dhe ambasadat e RSH-së dhe organizatat ndërkombëtare që adresojnë çështje të sigurisë ndërkombëtare.                       | MEPJ-ja                  | Numri i grave të shtuara në nivelin e lartë diplomatik.                                            | 2018–2020 | 37,008,000.00 | 0.00 | 0.00 |
| 2.2.3                                                                                                                                    | Emërimi apo caktimi i grave në pozicione drejtuese në organizatat ndërkombëtare që adresojnë çështje të sigurisë.                                                                                                          | MEPJ-ja                  | Numri i grave të emëruara/caktuara në pozicione drejtuese, pozicionet ku janë emëruar/caktuar gra. | 2018–2020 | 12,336,000.00 | 0.00 | 0.00 |



|                                                                                                                                                                                                               |                                                                                                                                                               |                                                                          |                                                                                                                                                  |           |              |      |              |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|--------------|------|--------------|
| 2.2.4                                                                                                                                                                                                         | Rritja e numrit të grave në nivele vendimmarrëse në mekanizmat për parandalimin, menaxhimin dhe zgjidhjen e konflikteve në nivel vendor, rajonal dhe qendror. | MEPJ-ja, MB-ja dhe MM-ja dhe OSHC-ja të specializuara për Rezolutën 1325 | Numri i grave të caktuara në nivele vendimmarrëse.                                                                                               | 2018–2020 | 31,320,00    | 0.00 | 0.00         |
| <b>Fusha e politikës 3. Mbrojtja dhe rehabilitimi</b>                                                                                                                                                         |                                                                                                                                                               |                                                                          |                                                                                                                                                  |           |              |      |              |
| <b>Objektivi specifik 3.1 Promovimi i mbrojtjes së grave dhe të vajzave viktime të dhunës me bazë gjinore lidhur kjo me situatat e konflikteve të armatosura dhe postkonflikte të tilla në vende të tjera</b> |                                                                                                                                                               |                                                                          |                                                                                                                                                  |           |              |      |              |
| 3.1.1                                                                                                                                                                                                         | Rishikimi i rregullave të brendshme për të përfshirë masa disiplinore për ushtruesit e dhunës me bazë gjinore mes personelit paqeruajtës.                     | MM-ja, MEPJ-ja dhe MSHMS-ja                                              | Rregulloret e brendshme të rishikuara - me parashikimin e masave disiplinore për ushtruesit e dhunës me bazë gjinore mes personelit paqeruajtës. | 2018–2020 | 222,840.00   | 0.00 | 0.00         |
| 3.1.2                                                                                                                                                                                                         | Rritja e ndërgjegjësimit për zero tolerancë ndaj shfrytëzimit seksual.                                                                                        | MEPJ-ja, MB-ja, MM-ja dhe MSHMS-ja                                       | Nr. i aktiviteteve, nr. i personave të ndërgjegjësuar.                                                                                           | 2018–2020 | 3,000,000.00 | 0.00 | 3,000,000.00 |
| <b>Objektivi specifik 3.2 Zbatimi i mbrojtjes së grave dhe të vajzave shqiptare viktime të luftës dhe me qëllim rehabilitimin pas konflikteve</b>                                                             |                                                                                                                                                               |                                                                          |                                                                                                                                                  |           |              |      |              |
| 3.2.1                                                                                                                                                                                                         | Mbledhja dhe analizimi i informacioneve për gratë dhe vajzat në luftë dhe ndikimit të luftës dhe situatave konfliktuale te gratë dhe vajzat në RSH.           | MB-ja dhe MM-ja                                                          | Pyetësorët e realizuar, të dhënat e përpunuara, analiza e publikuar.                                                                             | 2018–2020 | 1,337.040.00 | 0.00 | 0.00         |
| 3.2.2                                                                                                                                                                                                         | Rritja e ndërgjegjësimit për minat, bombat, eksplozivët e tjerë të mbetur pas situatave konfliktuale.                                                         | MB-ja dhe MM-ja                                                          | Nr. i aktiviteteve ndërgjegjësuere, nr. i personave të ndërgjegjësuar.                                                                           | 2018–2020 | 3,000,000.00 | 0.00 | 3,000,000.00 |
| 3.2.3                                                                                                                                                                                                         | Rritja e ndërgjegjësimit të grave e vajzave për mbledhjen e armëve të shpërndara në kundërshtim me ligjin në popullatë dhe fushata për mbledhjen e tyre.      | MB-ja dhe MM-ja                                                          | Nr. i aktiviteteve ndërgjegjësuere, nr. i personave të ndërgjegjësuar, nr. i armëve të dorëzuara.                                                | 2018–2020 | 2,400,000.00 | 0.00 | 2,400,000.00 |
| <b>Fusha e politikës 4. Zbatimi dhe monitorimi i Rezolutës 1325</b>                                                                                                                                           |                                                                                                                                                               |                                                                          |                                                                                                                                                  |           |              |      |              |
| <b>Objektivi 4.1 Përmirësimi i bashkëpunimit për zbatimin dhe monitorimin e Rezolutës 1325 (dhe të tjerave të lidhura me të)</b>                                                                              |                                                                                                                                                               |                                                                          |                                                                                                                                                  |           |              |      |              |
| 4.1.1.                                                                                                                                                                                                        | Inkurajimi i këmbimit të eksperiencës në nivel kombëtar lidhur me zbatimin e                                                                                  | MEPJ-ja, MB-ja dhe MM-ja dhe                                             | Nr. i aktiviteteve të zhvilluara, nr. i pjesëmarrësve.                                                                                           | 2018–2020 | 4,500,000.00 | 0.00 | 4,500,000.00 |



|                                                                                                         |                                                                                                                                            |                                                                                                         |                                                        |              |              |      |              |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------|--------------|--------------|------|--------------|
|                                                                                                         | rezolutës 1325 dhe të tjerave të lidhura me të, përmes organizimit të konferencave apo aktiviteteve të tjera.                              | OSHC-ja të specializuara për Rezolutën 1325                                                             |                                                        |              |              |      |              |
| 4.1.2                                                                                                   | Inkurajimi i këmbimit të eksperiencës në nivel ndërkombëtar e rajonal lidhur me zbatimin e Rezolutës 1325 dhe të tjerave të lidhura me të. | MEPJ-ja, MB-ja dhe MM-ja dhe OSHC-ja të specializuara për Rezolutën 1325/ AËSP, AËEN, Operation 1325    | Nr. i aktiviteteve të zhvilluara, nr. i pjesëmarrësve. | Shtator 2017 | 800,000.00   | 0.00 | 0.00         |
| 4.1.3                                                                                                   | Përfshirja e elementeve të agjendës GPS në raportimet rajonale dhe ndërkombëtare të vendit.                                                | MEPJ-ja, MB-ja, MSHMS-ja dhe MM-ja                                                                      | Nr. dhe llojet e raportimeve.                          | 2018–2020    | 668,520.00   | 0.00 | 0.00         |
| 4.1.4                                                                                                   | Hartimi i raporteve të monitorimit nga organizata të shoqërisë civile që mbështesin Rezolutën 1325, me qëllim zbatimin së saj.             | MEPJ-ja, MB-ja dhe MM-ja dhe OSHC-ja të specializuara për Rezolutën 1325/ Koalicioni për Rezolutën 1325 | Nr. dhe llojet e raportimeve.                          | 2018–2020    | 6,000,000.00 | 0.00 | 6,000,000.00 |
| <b>Objektivi 4.2 Mbështetja e zbatimit të plotë të Rezolutës 1325 (dhe të tjerave të lidhura me të)</b> |                                                                                                                                            |                                                                                                         |                                                        |              |              |      |              |
| 4.2.1                                                                                                   | Ngritja e grupit të punës për rishikimin e planit aktual dhe hartimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e Rezolutës 1325.                     | MEPJ-ja, MB-ja, MM-ja, MSHMS-ja në bashkëpunim me dhe OSHC-ja të specializuara për Rezolutën 1325       | Urdhri për ngritjen e grupit të punës                  | 2018         | 51,996.00    | 0.00 |              |

**VENDIM**

Nr. 525, datë 11.9.2018

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 313, DATË 1.7.2002, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ÇAKTIMIN E STRUKTURËS, TË NUMRIT TË PUNONJËSVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE TË POLICISË SË BASHKISË DHE KOMUNËS”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17, të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997, “Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe komunës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në lidhjen bashkëlidhur vendimit nr. 313, datë 1.7.2002, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 1, të kreut VI, numri maksimal i punonjësve të policisë bashkiake, për Bashkinë Durrës, bëhet 80 (tetëdhjetë) veta.

2. Në pikën 19, të kreut XXXIV, numri maksimal i punonjësve të policisë bashkiake, për Bashkinë Tiranë, bëhet 428 (katërqind e njëzet e tetë) veta.

3. Numri i përgjithshëm i punonjësve të policisë së bashkive bëhet, gjithsej, 1 315 (një mijë e treqind e pesëmbëdhjetë) veta.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**  
**Senida Mesi**

**VENDIM**

Nr. 527, datë 11.9.2018

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2018, NDËRMJET MINISTRISË SË BRENDSHME DHE MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË, PËR FINANCIMIN E STUDIM-PROJEKTIMIT PËR NDËRTIMIN E KORPUSIT TË POLICISË SË SHTETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.1998, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 18, të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm dhe të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2018, në programin buxhetor 09450, “Arsimi i lartë”, kapitulli “Shpenzime kapitale”, në artikullin 231, i pakësohet fondi prej 35 000 000 (tridhjetë e pesë milionë) lekësh.

2. Ministrisë së Brendshme, në buxhetin e miratuar për vitin 2018, në programin “Policia e Shtetit”, në kapitullin “Shpenzime kapitale”, i shtohet fondi prej 35 000 000 (tridhjetë e pesë milionë) lekësh, për t’u përdorur për financimin e studim-projektimit për ndërtimin e korpusit të Policisë së Shtetit.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**  
**Senida Mesi**

**VENDIM**

Nr. 528, datë 11.9.2018

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 34, DATË 20.1.2001, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SISTEMIMIN NË APARTAMENTE BANIMI TË FAMILJEVE QË BANOJNË NË TERRITORIN E PORTIT TË DURRËSIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 34/1 e 39/1, të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Pika 4, në vendimin nr. 34, datë 20.1.2001, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Procedurat e privatizimit të objekteve dhe lidhja e kontratës të bëhen brenda 2 (dy) vjetëve, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Në rast se familja nuk paraqitet pranë EKB-së për lidhjen e kontratës brenda afatit 2-vjeçar, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, asaj i humbet e drejta e privatizimit, por i ofrohet mundësia për t’u trajtuar me qira sociale. Nëse familja poseduese nuk pranon të lidhë kontratë qiraje, EKB-ja fillon ndjekjen e procedurave për lirimin e objektit që do të përdoret nga Enti Kombëtar i Banesave në zbatim të programeve sociale të strehimit.”.

2. Ngarkohen ministria përgjegjëse për strehimin dhe Enti Kombëtar i Banesave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**  
**Senida Mesi**

**VENDIM**

Nr. 532, datë 11.9.2018

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR TREGTIMIN, TRANSPORTIN, RUAJTJEN DHE MAGAZINIMIN E PRODUKTEVE PËR MBROJTJEN E BIMËVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 20, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:****I. QËLLIMI DHE PËRKUFIZIMET**

1. Qëllimi i këtij vendimi është zbatimi i kërkesave ligjore dhe përcaktimi i rregullave e procedurës për tregtimin, transportin, ruajtjen dhe magazinimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve të regjistruara.

2. Të gjithë termat e përcaktuar në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me ata të përcaktuar në ligjin nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”. Për efekt të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Import”, hyrja në territorin e Republikës së Shqipërisë të produkteve për mbrojtjen e bimëve (PMB) të regjistruara;

b) “Mjete mbrojtëse individuale (MMI)”, mjetet mbrojtëse që përdoren gjatë transportit, ruajtjes, tregtimit dhe përdorimit të PMB-ve. MMI-të janë dorezat mbrojtëse, veshjet mbrojtëse për trupin, maskat mbrojtëse për fytyrën, këpucët, që përdoren në të gjitha rastet, si dhe mbrojtëset e rrugëve të frymëmarrjes, që përdoren te PMB-të avulluese, si dhe në rastet e trajtimit të mjedisit të mbyllur;

c) “Magazinë”, objekti i veçantë, që shërben për ruajtjen dhe shpërndarjen me shumicë të PMB-ve të njësitë të tregtimit me pakicë;

ç) “Magazinim”, koha e qëndrimit të PMB-ve në magazinë;

d) “Dokumenti i të dhënave të sigurisë (MSDS)”, informacioni për përdoruesin apo shpërndarësin, për rreziqet që mund të shkaktojë PMB-ja, si dhe për trajtimin, ruajtjen e asgjësimin e sigurt të saj. MSDS-ja lëshohet nga prodhuesi i PMB-së dhe e shoqëron PMB-në nga prodhimi deri te tregtimi me pakicë;



dh) “Drejtues teknik i tregtimit të PMB-ve”, personi fizik, i diplomuar në fushën e agronomisë, i punësuar me kohë të plotë, që përgjigjet për gjithë veprimtarinë teknike e profesionale;

e) “Njësi e tregtimit me shumicë”, njësi që shërben për tregtimin e PMB-ve të njësitë e tregtimit me pakicë;

ë) “Njësi e tregtimit me pakicë”, njësi që shërben për ruajtjen, shpërndarjen dhe prezantimin për shitje ose shitjen e drejtpërdrejtë të PMB-ve të përdoruesi i fundit;

f) “Recetë”, formati për përshkrimin e PMB-së, i printuar dhe i lëshuar nga specialisti i diplomuar agronom.

## II. TREGTIMI ME SHUMICË I PRODUKTEVE PËR MBROJTJEN E BIMËVE

1. Në Republikën e Shqipërisë lejohet tregtimi me shumicë i PMB-ve të regjistruara.

2. Licenca e tregtimit me shumicë vendoset në një vend të dukshëm në njësinë e tregtimit me shumicë.

3. Çdo person i pajisur me licencë tregtimi me shumicë për PMB-të të klasifikuara “PMB të rrezikshme” dhe “PMB me rrezik të lartë” ka për detyrë:

a) Të hartojë një raport vjetor dhe ta paraqesë atë tek AKU-ja jo më vonë se muaji shkurt i vitit pasardhës, për sasinë dhe cilësinë e çdo PMB-je që ka importuar e hedhur në treg gjatë vitit të mëparshëm kalendarik;

b) të verë në dijeni AKU-në, me vetëdeklarim, për çdo efekt të dëmshëm të përdoruesi, mjedisi apo ekosistemi, njerëzit ose kafshët, që është vërejtur gjatë përdorimit, ekspozimit, përhapjes dhe shkarkimit të secilit PMB të importuar e të hedhur në treg.

4. Çdo person i pajisur me licencë tregtimi me shumicë, që kërkon të importojë PMB të klasifikuara “PMB të rrezikshme” dhe “PMB me rrezik të lartë”, duhet të njoftojë me parë SPMB-në për çdo ngarkesë. Njoftimi duhet të përmbajë të dhënat, si më poshtë vijon:

a) Emrin tregtar të PMB-së;

b) Numrin dhe datën e regjistrimit;

c) Emrin e lëndës/ve vepruese;

ç) Emrin e mbajtësit të dokumentit të regjistrimit (aplikantit);

d) Emrin e prodhuesit;

dh) Sasinë;

e) Vendin e origjinës, ku është prodhuar;

ë) Vendin nga importohet.

5. Njoftimi bëhet 1 deri në 3 ditë pune përpara datës së hyrjes së tyre në Republikën e Shqipërisë.

6. Inspektori i mbrojtjes së bimëve në pikat e kalimit kufitar (PIK), në zbatim të këtij vendimi, ka për detyrë:

a) Të kontrollojë e të verifikojë çdo parti PMB-je që hyn për t'u përdorur në Republikën e Shqipërisë dhe t'i evidentojë ato në një libër të veçantë, sipas shtojcës nr. 3 që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) Të ndalojë hyrjen në Republikën e Shqipërisë të PMB-ve të paregjistruara dhe kur vëren shkelje në lidhje me etiketimin e ambalazhimit të tyre.

7. Inspektimi i PMB-ve që ndodhen në treg, lidhur me plotësimin e kërkesave ligjore për tregtim, kryhet në bazë të planit vjetor të inspektimeve me bazë risku, të miratuar nga ministri.

Kontrolli për cilësinë e PMB-ve të vendosura në treg kryhet në bazë të planit vjetor të marrjes dhe analizimit të mostrave, të miratuar nga ministri.

8. Analizat cilësore të PMB-ve kryhen nga Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV), i cili njofton me shkrim AKU-në, brenda 10 ditëve, për rezultatin e analizave.

9. Marrja e mostrave dhe analizimi i tyre kryhen sipas pikave 1, 2, 3, 4 e 5, të nenit 38, të kreut V, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

## III. TREGTIMI ME PAKICË I PRODUKTEVE PËR MBROJTJEN E BIMËVE

1. Në Republikën e Shqipërisë lejohet tregtimi me pakicë i PMB-ve të regjistruara.

2. Licenca e tregtimit me pakicë vendoset në një vend të dukshëm në njësinë e tregtimit me pakicë.

3. Njësitë e tregtimit me pakicë shërbejnë për shitjen e drejtpërdrejtë të PMB-ve të përdoruesi i fundit.

4. Të dhënat për PMB-të e klasifikuara “PMB të rrezikshme” ose “PMB me rrezik të lartë”, që mbahen nga njësitë e tregtimit me pakicë, janë sipas shtojcës nr. 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi.



5. Çdo person i pajisur me licencë tregtimi me pakicë për PMB-të e klasifikuara “PMB të rrezikshme” dhe “PMB me rrezik të lartë” ka për detyrë të hartojë një raport vjetor dhe ta paraqesë atë tek AKU-ja jo më vonë se muaji janar i çdo viti, për sasinë dhe cilësinë e secilit PMB që ka hedhur në treg gjatë vitit të mëparshëm kalendarik.

6. Shitja e PMB-ve “helmuese” dhe PMB-ve “shumë helmuese” kryhet në bazë të recetës së lëshuar nga specialisti i diplomuar agronom.

7. Lëshuesi i recetës mban përgjegjësi, në rast plotësimi të pasaktë të saj, për dëmin e shkaktuar te bimët ose produktet bimore të trajtuara.

8. Ekzekutuesi i recetës mban përgjegjësi, në rast ekzekutimi të gabuar të saj, për dëmin e shkaktuar te bimët ose produktet bimore të trajtuara.

Recetat ruhen në njësitë e tregtimit me pakicë për një periudhë 3-vjeçare.

9. Shitja e PMB-ve shumë helmuese lejohet vetëm për përdoruesit profesionistë, të cilët janë persona të diplomuar në fushën e agronomisë ose persona, të cilët i janë nënshtruar një trajnimit të përshtatshëm për përdorimin e PMB-ve shumë të rrezikshme dhe janë të pajisur me dëshmi aftësie të veçantë për këtë përdorim.

#### IV. TRANSPORTI I PRODUKTEVE PËR MBROJTJEN E BIMËVE

1. Transporti i PMB-ve të klasifikuara “PMB të rrezikshme” dhe “PMB me rrezik të lartë” kryhet sipas legjislacionit shqiptar në fuqi për transportin e mallrave dhe substancave të rrezikshme.

2. Mjetet që transportojnë PMB “helmuese” dhe “shumë helmuese” duhet të plotësojnë kërkesat teknike, si më poshtë vijon:

a) Të kenë shenjat dalluese, karakteristike, të tyre;

b) Hapësira e brendshme e mjetit duhet të jetë e pastër, e thatë, pa objekte që mund të dëmtojnë ambalazhin (gozhda apo pjesë të tjera metalike);

c) Mbulesa e mjetit duhet të jetë e padëmtuar dhe e papërshkueshme nga uji e ndriçimi diellor;

ç) Spondat dhe mbulesa duhet të kenë mbyllje shumë të mirë;

d) Për PMB-të e ndezshme, bazamenti i karrocërës, spondat dhe mbulesa duhet të jenë prej hekuri, alumini ose të trajtuara me materiale të qëndrueshme ndaj zjarrit;

dh) Të kenë MMI specifike (doreza, rroba, maska, syze, këpucë ose çizme);

e) Të jenë të pajisura me mjetet kundër zjarrit;

ë) Të jenë të pajisura me materiale që neutralizojnë PMB-të e derdhura nga dëmtimi.

3. Ndalohet rreptësisht transporti i:

a) PMB-ve me mjete që transportojnë njerëz dhe kafshë;

b) Ushqimeve për njerëz dhe kafshë së bashku me PMB-të.

4. Transporti i PMB-ve kryhet vetëm në ambalazhet e tyre origjinale.

5. Kur, gjatë transportit, dëmtohet ambalazhi dhe PMB-ja derdhet, mjeti i transportit duhet të ndalojë dhe drejtuesi i mjetit duhet të marrë masa për ndalimin e rrjedhjes e shmangien e dëmtimit/e ndotjes së mjedisit përreth. Për të thithur e dezaktivizuar lëngjet përdoren dherishte, tallash apo gëlqere, fshihet me kujdes dhe grumbullohet në një enë të veçantë PMB-ja e derdhur. Nxjerrija e tyre jashtë përdorimit bëhet në përputhje me legjislacionin për menaxhimin e integruar të mbetjeve. Në rastin e dëmtimit aksidental të ambalazheve duhet të përdoren MMI (të paktën dorezat).

6. Mjetet e transportit të PMB-ve mund të përdoren për qëllime të tjera vetëm pasi të jenë pastruar mirë, larg qendrave të banuara, burimeve dhe kanaleve të ujit, lumenjve e ujëmbledhësve.

7. Ambalazhet më të rënda dhe/ose ato që përmbajnë PMB të lëngëta duhet të vendosen në shtresat e poshtme të ngarkesës.

8. PMB-ja, gjatë transportit, duhet të jetë e shoqëruar me MSDS-në përkatëse, edhe në gjuhën shqipe.

#### V. RUAJTJA DHE MAGAZINIMI I PRODUKTEVE PËR MBROJTJEN E BIMËVE

1. PMB-të ruhen në magazina, në rastin e tregtimit me shumicë dhe në mjediset e tregtimit me pakicë.

2. Magazinat ndërtohen ose përshtaten në mënyrë të tillë që të garantojnë ruajtjen e cilësive fiziko-kimike të PMB-ve brenda afateve të skadencës dhe të sigurojnë një nivel temperature të mjedisit, sipas kërkesave të caktuara në etiketën e PMB-ve për ruajtjen dhe magazinimin e tyre. Për këtë qëllim, magazinat duhet të jenë të pajisura me sisteme ajrimi.



Kushtet e magazinimit duhet të garantojnë, në çdo kohë, shëndetin dhe sigurinë e personelit të punësuar.

3. Miratimi për garantimin e funksionimit të magazinave të tregtimit me shumicë të PMB-ve jepet brenda 10 ditëve nga:

a) Inspektorati përgjegjës për shëndetësinë, në zbatim të legjislacionit për shëndetin publik;

b) Inspektorati përgjegjës për mjedisin, në zbatim të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet mjedisore”, të ndryshuar;

c) Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi (MZSH), në zbatim të ligjit nr. 152/2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.

AKU-ja kontrollon dokumentacionin e lëshuar sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c”, të kësaj pike.

4. Kërkesat që duhet të plotësohen për magazinimin e PMB-ve janë si më poshtë vijon:

a) PMB-të duhet të jenë të identifikuara, nëpërmjet certifikatës së origjinës dhe të cilësisë;

b) Hyrja/dalja e PMB-ve nga magazina bëhet me dokumente të rregullta dhe shënimet përkatëse pasqyrohen në librin e magazinës, sipas shtojcës nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi;

c) PMB-të vendosen në paletë të ndara nga njëra-tjetra, në një largësi jo më të vogël se 0.5m, të ambalazuara në mënyrë të rregullt, në ambalazhe origjinale dhe me etiketat e miratuara, sipas dokumentit të regjistrimit të PMB-së;

ç) PMB-të e lëngëta vendosen në lartësi jo më të madhe se 3.5m, ndërsa PMB-të e ngurta vendosen në lartësi deri në 2.5 m.

5. Njësitë e tregtimit me pakicë të PMB-ve duhet të ndërtohen ose të përshtaten në mënyrë të tillë që të garantojnë ruajtjen e cilësive fiziko-kimike të tyre, të sigurojnë një nivel temperature mjedisi, sipas kërkesave të caktuara në etiketën e PMB-ve për ruajtjen e tyre.

6. Kur, gjatë ruajtjes së PMB-ve në magazina ose njësitë e tregtimit me pakicë ndodhin dëmtime të ambalazheve dhe rrjedhje të PMB-ve, ato largohen menjëherë nga magazina dhe njësia e tregtimit dhe asgjësohen sipas rregullave në fuqi.

7. Nëse PMB-të, brenda ambalazheve të dëmtuara, janë në gjendje të mirë, ato futen në ambalazhe me etiketa origjinale, në prani të AKU-së. Ky veprim shoqërohet me mbajtjen e një procesverbal, në dy kopje, për të mënjanuar abuzimet që mund të ndodhin me riambalazhimin e PMB-ve në këto mjedise.

8. Përdoruesit e fundit i ruajnë PMB-të në mjedise të veçanta, si: kasaforta, dhoma, depo të siguruar nga hapjet e paautorizuara, në ambalazhe origjinale, larg fëmijëve, në kushte të thata, larg zjarrit, të mbrojtura nga rrezet e drejtpërdrejta të diellit, si dhe duke respektuar të gjitha udhëzimet e veçanta që jepen në etiketë.

9. AKU-ja informon me shkrim:

a) Drejtorinë përgjegjëse për statistikën në ministri dhe SPMB-në, brenda muajit mars të çdo viti, për sasinë e secilit PMB që është importuar dhe është tregtuar gjatë vitit të mëparshëm kalendarik, sipas shtojcave nr. 4 e nr. 5, që i bashkëlidhen këtij vendimi;

b) SPMB-në, për probleme të veçanta që kanë lidhje me kontrollin e PMB-ve;

c) SPMB-në, për çdo efekt të dëmshëm të përdoruesit, mjedisi apo ekosistemi, njerëzit ose kafshët, që është vërejtur gjatë përdorimit, ekspozimit, përhapjes, shkarkimit ndaj secilit PMB të importuar e të hedhur në treg, bazuar në vetëdeklarimin, sipas shkronjës “b”, të pikës 3, të kreut II, të këtij vendimi.

#### VI. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Vendimi nr. 1188, datë 20.8.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për importimin, tregtimin, transportin, ruajtjen, përdorimin dhe asgjësimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve”, i ndryshuar, shfuqizohet, me përjashtim të krerëve V, VI e VIII, si dhe të shtojcave 10, 11 e 12, të cilat mbeten në fuqi deri në nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”.

2. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
Senida Mesi

Emri tregtar i PMB-së \_\_\_\_\_

[illegible]

Page | 9203



## SHTOJCA NR. 2

## LIBRI I SHITJES ME PAKICË TË PMB-ve “TË RREZIKSHME” DHE PMB-ve “ME RREZIK TË LARTË”

Emri tregtar i PMB-së \_\_\_\_\_

| Nr. | FURNIZUAR        |                   |            |                   | SHITUR                    |                                      |                     |                |          |
|-----|------------------|-------------------|------------|-------------------|---------------------------|--------------------------------------|---------------------|----------------|----------|
|     | Emri i subjektit | Nr. i fletëhyrjes | Sasia kg/l | Data e furnizimit | Emri e mbiemri i blerësit | Lloji dhe nr. i dëshmisë së aftësisë | Sasia e shitur kg/l | Data e shitjes | Vërejtje |
|     |                  |                   |            |                   |                           |                                      |                     |                |          |
|     |                  |                   |            |                   |                           |                                      |                     |                |          |
|     |                  |                   |            |                   |                           |                                      |                     |                |          |
|     |                  |                   |            |                   |                           |                                      |                     |                |          |
|     |                  |                   |            |                   |                           |                                      |                     |                |          |
|     |                  |                   |            |                   |                           |                                      |                     |                |          |
|     |                  |                   |            |                   |                           |                                      |                     |                |          |
|     |                  |                   |            |                   |                           |                                      |                     |                |          |
|     |                  |                   |            |                   |                           |                                      |                     |                |          |
|     |                  |                   |            |                   |                           |                                      |                     |                |          |
|     |                  |                   |            |                   |                           |                                      |                     |                |          |
|     |                  |                   |            |                   |                           |                                      |                     |                |          |
|     |                  |                   |            |                   |                           |                                      |                     |                |          |
|     |                  |                   |            |                   |                           |                                      |                     |                |          |
|     |                  |                   |            |                   |                           |                                      |                     |                |          |
|     |                  |                   |            |                   |                           |                                      |                     |                |          |
|     |                  |                   |            |                   |                           |                                      |                     |                |          |
|     |                  |                   |            |                   |                           |                                      |                     |                |          |
|     |                  |                   |            |                   |                           |                                      |                     |                |          |
|     |                  |                   |            |                   |                           |                                      |                     |                |          |

**Shënim.** Këto të dhëna mbahen në regjistrin e njësisë së tregtimit me pakicë.

[illegible]

Faqe | 9205



## SHTOJCA NR. 4

## PASQYRA PËRMBLEDHËSE E IMPORTIT TË PMB-ve

| Nr. | Emri tregtar i PMB-së | Emri i lëndës vepruese | Pika e inspektimit kufitar | Data e kalimit | Emri i prodhuesit | Vendi i origjinës | Vendi nga importohet | Emri i blerësit/ firmës importuese |  |
|-----|-----------------------|------------------------|----------------------------|----------------|-------------------|-------------------|----------------------|------------------------------------|--|
|     |                       |                        |                            |                |                   |                   |                      |                                    |  |
|     |                       |                        |                            |                | Sasia<br>kg/l     |                   |                      |                                    |  |
|     |                       |                        |                            |                |                   |                   |                      |                                    |  |
|     |                       |                        |                            |                |                   |                   |                      |                                    |  |
|     |                       |                        |                            |                |                   |                   |                      |                                    |  |
|     |                       |                        |                            |                |                   |                   |                      |                                    |  |
|     |                       |                        |                            |                |                   |                   |                      |                                    |  |
|     |                       |                        |                            |                |                   |                   |                      |                                    |  |
|     |                       |                        |                            |                |                   |                   |                      |                                    |  |
|     |                       |                        |                            |                |                   |                   |                      |                                    |  |
|     |                       |                        |                            |                |                   |                   |                      |                                    |  |
|     |                       |                        |                            |                |                   |                   |                      |                                    |  |
|     |                       |                        |                            |                |                   |                   |                      |                                    |  |
|     |                       |                        |                            |                |                   |                   |                      |                                    |  |
|     |                       |                        |                            |                |                   |                   |                      |                                    |  |

**Shënim.** Këto të dhëna raportohen tek AKU-ja, ndërsa AKU-ja i raporton te drejtoria përgjegjëse për statistikën dhe SPMB-ja në ministri.

[illegible]

Page | 9207

**VENDIM****Nr. 533, datë 11.9.2018****PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË  
MJEKIMIT TË Z. SPIRO DEDE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Spiro Dede, në masën 2 134 350 (dy milionë e njëqind e tridhjetë e katër mijë e treqind e pesëdhjetë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Paga të bëhet me paraqitjen e faturave të institucionit të kurimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**  
**Senida Mesi**

|  |                 |
|--|-----------------|
|  | Formati 61x86/8 |
|--|-----------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë  
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 252 lekë